

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË  
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ  
FACULTY OF LAW

**STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**DREJTIMI: E DREJTA PENALE**

**TEZA:**

**PORNOGRAFIA FËMIJËRORE SI FORMË E KRIMIT KIBERNETIK**

**KANDIDATI:**

**Xhejda Ismaili**

**MENTORI:**

**Doc. Dr. Vedije Ratkoceri**

**Tetovë, Dhjetor, 2021**



## ABSTRAKT

Me zhvillimin e teknologjisë, krimet kanë filluar të zhvendosen në mjedisin digjital, dhe si pasojë e kësaj është ndryshuar edhe mënyra e kryerjes së krimeve. Teknologjia bëhet vendi i ri i kriminelëve për të kryer krime, pasi që mjetet teknologjike janë shndërruar si mjete për të kryer çdo lloj të krimi. Si pasojë e zhvillimeve teknologjike jo vetëm që krimet klasike u shndërruan në krimet kibernetike, por në të njëjtën kohë u përhapën edhe forma të reja të krimeve.

Një ndër format më të rrezikshme të krimi kibernetik është edhe *Pornografia Kibernetike Fëmijërore*, e cila është edhe objekt studimi i këtij punimi. Pornografia me fëmijë është një fenomen mjaft i vjetër, e cila ka qenë prezente edhe para shpikjes së internetit. Por, me ardhjen e internetit është shndërruar nga krimi klasik në krimin kibernetik. Faktori kryesor që ka kontribuar në këtë rezultat është se, në ditët e sotme shpërndarja e materialeve pornografike nuk kryhet më nëpërmjet metodave tradicionale, të tilla si magazinat apo revistat, por nëpërmjet shërbimeve të fshehura të internetit. Madje, interneti nuk e ka ndryshuar vetëm mënyrën e shpërndarjes së materialeve të tilla, por edhe mënyrën e prodhimit. Me mjetet teknologjike është bërë e mundshme krijimi i imazheve pornografike me fëmijë, pa pasur nevojë për një fëmijë të vërtetë.

Në këtë punim është shtjelluar në mënyrë të detajshme fenomeni i pornografisë kibernetike fëmijërore, duke e analizuar se si ka evoluar nga krimi klasik në kibernetik, cilat janë llojet, kush janë kryerësit, kush janë viktimat, çfarë masash janë marrë dhe duhet ndërmarrë nga shtetet për parandalimin e këtij fenomeni.

**Fjalët kyçe:** *krimi kibernetik, pornografia kibernetike fëmijërore, teknologjia e informatikës, kriminelët kibernetik.*

## ABSTRACT

With the development of technology, crimes have begun to shift to the digital environment, and as a result, the way crimes are committed has changed. Technology is becoming the new place for criminals to commit crimes, as technological tools have become the means to commit almost any type of crime. As a result of technological developments, not only do classical crimes turn into cybercrime, but new forms of crime spread as well.

One of the most dangerous forms of cybercrime is *Cyber Child Pornography*, which is also the main topic of this research. Child pornography is a very old phenomenon, which was present even before invention of the internet. But, with the invention of the Internet it has transformed from a classic crime to a cyber one. The main factor that has contributed to this result is the fact that, nowadays the distribution of pornographic material is no longer done through traditional methods, such as magazines, but through the hidden services of the Internet instead. Moreover, the Internet has not only changed the way such materials are distributed, but also the ways of production. With technological tools it has become possible to create pornographic images with children, without the need for a real child.

This Master thesis discusses the phenomenon of cyber child pornography in detail, analyzing how it has evolved from traditional crime to cybercrime, what are the types, who are the perpetrators, who are the victims, what measures have been and should be taken by countries to prevent this phenomenon.

**Key words:** *cybercrime, cyber child pornography, information technology, cybercriminals.*

## **PËRMBAJTJA**

|                      |          |
|----------------------|----------|
| <b>ABSTRAKT.....</b> | <b>3</b> |
| <b>ABSTRACT.....</b> | <b>4</b> |
| <b>HYRJE.....</b>    | <b>8</b> |

### **KAPITULLI I PARË**

|  |           |
|--|-----------|
| <b>Vështrime të përgjithshme rreth krimit kibernetik .....</b> | <b>11</b> |
| 1. Hapësira kibernetike .....                                  | 11        |
| 2. Kuptimi i krimit kibernetik .....                           | 12        |
| 3. Karakteristikat e krimit kibernetik.....                    | 14        |
| 3.1. Kufijtë e krimit kibernetik .....                         | 14        |
| 3.2. Hetimi i krimit kibernetik .....                          | 14        |
| 3.3. Anonimiteti i krimit kibernetik.....                      | 15        |
| 4. Tipologjitë e krimit kibernetik .....                       | 16        |
| 5. Format e krimit kibernetik .....                            | 17        |
| 5.1. Hakingu.....  | 17        |
| 5.2. Viruset kibernetike .....                                 | 17        |
| 5.3. Mashtrimet kibernetike.....                               | 18        |
| 5.4. Fishingu .....  | 18        |
| 5.5. Falsifikimi kibernetik.....                               | 18        |
| 5.6. Sabotazhi kibernetik.....                                 | 19        |
| 5.7. Bullizmi kibernetik.....                                  | 19        |
| 5.8. Pornografia kibernetike fëmijërore .....                  | 19        |

### **KAPITULLI I DYTË**

|   |           |
|---|-----------|
| <b>Pornografia fëmijërore si formë e krimit kibernetik.....</b> | <b>21</b> |
| 1. Evolucioni i pornografisë fëmijërore .....                   | 21        |
| 2. Kuptimi i pornografisë fëmijërore.....                       | 22        |
| 3. Klasifikimi dhe llojet e pornografisë fëmijërore .....       | 23        |
| 4. Format e manifestimit të pornografisë fëmijërore .....       | 25        |

|   |    |
|---|----|
| 5. Kryerësit e pornografisë fëmijërore .....              | 26 |
| 5.1. Tipologjia e kryerësve.....                          | 26 |
| 5.2. Karakteristikat e kryerësve.....                     | 28 |
| 6. Viktimat e pornografisë fëmijërore .....               | 29 |
| 6.1. Moshat e viktimave .....                             | 29 |
| 6.2. Efektet e dëmshme tek viktimat .....                 | 31 |
| 7. Të dhëna statistikore për pornografinë fëmijërore..... | 32 |
| 7.1. Pornografia fëmijërore në rrjete sociale.....        | 33 |
| 7.2. Profili i viktimave.....                             | 35 |

## **KAPITULLI I TRETË**

### **Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia fëmijërore .....38**

|  |    |
|--|----|
| 1. Konventa për krimin kibernetik .....  | 38 |
| 2. Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual.....                                     | 40 |
| 3. Protokollin Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë fëmijërore ..... | 41 |
| 4. Direktiva e Parlamentit Evropian „Për luftën ndaj abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografinë fëmijërore” .....       | 43 |

## **KAPITULLI I KATËRT**

### **Vështrime krahasuese të pornografisë fëmijërore .....46**

|   |    |
|---|----|
| 1. Rishikimi legjislativ global .....   | 46 |
| 2. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.....            | 53 |
| 2.1. Pornografia fëmijërore në Ligjin Federal .....   | 53 |
| 2.2. Njësia hetimore e teknologjisë së lartë.....   | 54 |
| 2.3. Child Exploitation and Obscenity Section .....   | 55 |
| 2.4. Detyrimet e Ofruesve të Shërbimit të Internetit në lidhje me pornografinë fëmijërore ..... | 55 |
| 3. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Suedisë.....                                      | 56 |

|  |           |
|--|-----------|
| 3.1. Masat për parandalimin e pornografisë fëmijërore sipas Aktit mbi përgjegjësinë për tabelat elektronike të njoftimeve (1998: 112)..... | 57        |
| 3.2. Masat për bllokimin e faqeve të internetit.....   | 57        |
| 3.3. Qendra Suedeze e Krimit Kibernetik .....  | 58        |
| 4. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Turqisë .....  | 58        |
| 4.1. Departamenti i luftimit kibernetik .....  | 59        |
| 5. Pornografia fëmijërore në vendet e rajonit ballkanik .....  | 60        |
| 5.1. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Shqipërisë.....  | 60        |
| 5.2. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Kosovës .....  | 62        |
| 6. Pornografia fëmijërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....  | 63        |
| 6.1. Pornografia fëmijërore në Kodin penal të RMV .....  | 63        |
| 6.2. Regjistri i personave të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë.....                                  | 66        |
| 6.3. Të dhënat statistikore për veprën penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore përmes sistemit kompjuterik” në RMV..... | 67        |
| <b>KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET.....</b>  | <b>69</b> |
| <b>BIBLIOGRAFIA.....</b>   | <b>74</b> |

## HYRJE

Në vitet e fundit pornografia fëmijërore është shndërruar si krimi më i përhapur dhe më i rrezikshëm në kontestin e krimeve kibernetike. Në këtë punim, pornografia fëmijërore që konsiderohet si një krim me të cilin cenohen të drejtat elementare të fëmijëve dhe gjithashtu që shkaktohen dëmtime të mëdha tek fëmijët është shtjelluar në shume dimensione.

Për studimin e pornografisë kibernetike fëmijërore, me rëndësi është që më së pari të analizohet se çfarë nënkuptohet me krimin kibernetik. Andaj në kapitullin e parë të punimit, është analizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse krimi kibernetik, duke përfshirë hapësirën kibernetike se ku kryhen këto krime, kuptimin, tipologjinë, format dhe karakteristikat e kimit kibernetik.

Në kapitullin e dytë janë analizuar në mënyrë të detajuar karakteristikat e pornografisë kibernetike fëmijërore. Fillimisht duke e njohur historinë e saj, pra se si ka evoluar nga ajo klasike në kibernetike, më pas duke e përcaktuar se çfarë nënkuptohet me pornografinë, cilat janë llojet e saj, në çfarë forma kryhet, kush janë kryerësit, tipologjia, karakteristikat si dhe motivet e tyre. Pasi të përcaktohen të gjithë detajet rreth këtij krimi, në kapitullin e dytë gjithashtu do të analizohen edhe viktimat e këtij krimi, profili i viktimave, raporti i viktimave me viktimizuesit e tyre si dhe efektet e dëmshme që shkaktohen viktimave.

Në kapitullin e tretë janë shtjelluar instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual.

Në kapitullin e fundit është bërë një rishikim legjislativ global, ku janë paraqitur të dhëna për legjislacionin e të gjithë shteteve në botë, sa i përket kontributit të tyre për luftimin dhe parandalimin e pornografisë fëmijërore. Gjithashtu në këtë kapitull përmes një analize komparative, janë shtjelluar juridiksionet e disa shteteve më të zhvilluara se si e kanë përkufizuar pornografinë fëmijërore dhe cilat janë institucionet kompetente për luftimin e kësaj vepre.



## **Qëllimet e hulumtimit**

Qëllimi shkencor i këtij punimi është që duke i njohur karakteristikat e krimit kibernetik në përgjithësi dhe pornografisë fëmijërore në veçanti të përcaktohen metodat dhe mënyrat më të suksesshme për parandalimin e këtij kriminaliteti. Është i njohur fakti që, lufta ndaj kriminalitetit fiton një ndjeshmëri dhe rëndësi të veçantë, veçanërisht përse i përket faktorit ku si viktimat paraqiten fëmijët.

Të jetuarit në ekopën digjitale, aq sa i ka përfitimet e veta i ka edhe rreziqet, ku çdo fëmijë është vetëm një klikim larg nga rreziqet dhe kërcënimet në këtë shoqëri digjitale. Andaj, qëllimi i këtij punimi gjithashtu është që të kontribuojë në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi i tyre në internet.

## **Hipotezat**

Gjatë këtij punimi shkencor do të parashtrohen disa hipoteza, të cilat gjatë shkrimit të punimit do të vërtetohen.

Hipoteza e parë: Pornografia fëmijërore në shumë juridiksione në botë nuk është përcaktuar si veprë penale, dhe kjo ndikon në rritjen e rasteve. Shumë kriminelë kibernetikë e kanë inteligjencën për të shfrytëzuar zbrazëtira të tilla.

Hipoteza e dytë: Mungesa e bashkëpunimit midis shteteve si dhe mungesa e mjeteve ndërkombëtare të përbashkëta e vështirëson parandalimin e këtij kriminaliteti.

Hipoteza e tretë: Numri i errët është shumë i lartë, veçanërisht në RMV ku mungon një ligj i veçantë për krimin kibernetik si dhe persona kompetente të trajnuar dhe të aftësuar për hetimin dhe identifikimin e këtyre krimeve dhe autorët e tyre.

## **Metodologjia e hulumtimit**

Për hulumtimin e lëndës të këtij punimi është shfrytëzuar një numër i konsiderueshëm i metodave. Fillimisht, janë përdorur metodat normative dhe dogmatike, për interpretimin e normave me të cilat përkufizohen veprat penale të pornografisë fëmijërore. Gjithashtu është

përdorur metoda historike me të cilën është analizuar evoluimi i pornografisë fëmijërore gjatë historisë, se si janë ndryshuar format e manifestimit të saj me zhvillimin e teknologjisë.

Po ashtu është përdorur metoda statistikore si një metodë shumë e rëndësishme për dhënien e një pasqyre reale mbi numrin e rasteve të pornografisë fëmijërore, ku në mënyrë tabelore janë paraqitur të dhënat nga burimet zyrtare të shteteve të ndryshme si dhe të dhënat nga Enti Shtetëror Statistikori i RMV-së për rastet në shtetin tonë. Metoda hulumtuese krahasimore është shfrytëzuar gjatë analizës së legjislacioneve të shteteve sa i përket kontributit të tyre për mbrojtjen dhe parandalimin e pornografisë fëmijërore në internet. Metoda të tjera që janë përdorur gjatë hulumtimit janë: metoda grafike, metoda e klasifikimit, metoda e kompilimit dhe metoda e deskripcionit.

### **Rëndësia e punimit**

Studimi i këtij fenomeni ka rëndësi të madhe, ngase pornografia fëmijërore, e cila është një nga llojet më të përhapura të krimit kibernetik, përbën një nga kërcënimet më të mëdha të së ardhmes me zhvillimet në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Ky fenomen zë vendin e parë në mesin e problemeve që kërcënojnë botën jo vetëm mbi baza kombëtare, por edhe në atë ndërkombëtare.

Zhvillimet teknologjike, dhe veçanërisht përdorimi i gjerë i internetit, kanë sjellë një identitet global në tregtinë e pornografisë fëmijërore dhe kanë bërë që ajo të zhvillohet me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Në vitet e fundit, pornografia fëmijërore gjithashtu ka ndryshuar bilancin tregtar dhe ka zënë vendin e saj si një nga industritë më të përhapura dhe më në trend në treg. Kjo na dëshmon që ky krim do të vazhdojë të rritet edhe më tutje. Hulumtimi i detajshëm në këtë fushë kontribuon ofrimin e njohurive themelore të këtij krimi, gjithnjë me qëllim të pengimit dhe luftimit të tij.

## KAPITULLI I PARË

### Vështrime të përgjithshme rreth krimit kibernetik

#### 1. Hapësira kibernetike

Etimologjikisht, fjala „kibernetikë” vjen nga gjuha greke „kubernētēs” që do të thotë pilot, guvernator apo sundimtar<sup>1</sup>.

Termin „hapësirë-kibernetike”, për herë të parë e përdori autori William Gibson në tregimin e tij „Burning Chrom” në vitin 1962, për t’iu referuar një realiteti virtual të gjeneruar nga kompjuteri. Sidoqoftë, termi u bë i njohur në vitin 1984 pasi autori Gibson e përdori në romanin e tij „Neuromancer”. Në këtë roman fantastiko-shkencor, Gibson përshkroi hapësirën kibernetike si „krijimi i një rrjeti kompjuterik në një botë të mbushur me qenie inteligjente-artificiale”.<sup>2</sup>

Gjithsesi këto koncepte kanë qenë të përcaktuara nga autori Gibson në romane fantastiko-shkencor, por parashtrohet pyetja se çfarë nënkuptohet me hapësirën kibernetike në realitet?

Në literaturë janë të përcaktuar disa përkufizime sa i përket hapësirës kibernetike. Sipas njërit përkufizim me hapësirën kibernetike nënkuptohet „një fushë globale brenda mjedisit të informatikës, që përbëhet nga rrjeti i ndërvarur i infrastrukturës së teknologjisë së informatikës dhe të dhënave të rezidentëve, duke përfshirë internetin, rrjetet telekomunikuese, sistemet kompjuterike dhe procesorët si dhe kontrolluesit e ngulitur”.<sup>3</sup> Edhe pse me këtë përkufizim janë përcaktuar tiparet themelore të hapësirës kibernetike, prapë se prapë nuk konsiderohet një përkufizim gjithpërfshirës sepse nuk janë të përcaktuar programet softuerike. Një përkufizim më gjithpërfshirës është ofruar nga autori Kuehl, sipas të cilit „hapësira kibernetike është një fushë globale brenda mjedisit të informacionit, karakteri i veçantë dhe unik i të cilit rregullohet

<sup>1</sup> Apeline Security, What is the origin of the word „cyber”? <https://alpinesecurity.com/blog/what-is-the-origin-of-the-word-cyber> (qasja e fundit më 02.06.2021).

<sup>2</sup> Fourkas, Vassily. (2004). What is ‘cyberspace’?. <https://www.researchgate.net/publication/328928631> (qasja e fundit më 02.06.2021).

<sup>3</sup> Tsagourias Nicholas, The legal status of cyberspace, Edward Elgar Publishing, 2015, fq.15.

nga përdorimi i elektronikës dhe spektrit elektromagnetik për të krijuar, ruajtur, modifikuar, shkëmbyer dhe shfrytëzuar informacionin përmes rrjeteve të ndërvarura dhe të ndërlidhura duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit”<sup>4</sup>.

Pra, me hapësirën kibernetike nënkuptojmë hapësirën virtuale, jo-fizike e krijuar nga rrjetet kompjuterike, ku njerëzit mund të komunikojnë dhe të shkëmbejnë informacione në mënyra të ndryshme. Hapësira kibernetike përfaqëson mediumin e ri të komunikimit, pra komunikimin elektronik i cili po tejkalon, ose madje zëvendëson metodat tradicionale të komunikimit.

## **2. Kuptimi i krimit kibernetik**

Me anë të zhvillimeve teknologjike, ku shumë aktivitete të njerëzve janë transferuar në mediat elektronike, është krijuar një mjedis i përshtatshëm për kriminelët kibernetik për të zbuluar mjete dhe metoda të reja të krimit.

Me qëllim të identifikimit të krimeve të kryera në hapësirën kibernetike janë krijuar terme të reja, si: „Siguria kibernetike”; „krimi kibernetik”; „krimi elektronik”; „krimi i teknologjisë së lartë”; „krimi i digjitalizuar” si dhe „krimi kompjuterik”, ku IT (teknologjia e informacionit apo informatike) luan rolin kryesor në realizimin e veprës penale.<sup>5</sup>

Me krimin kibernetik nënkuptohet çdo veprimtari kriminale, e kryer duke përdorur një kompjuter, veçanërisht për të hyrë, transmetuar ose manipuluar në mënyrë të paligjshme të dhënat<sup>6</sup>.

Edhe pse ekzistojnë terme të ndryshme për të identifikuar krimet e kryera në hapësirën kibernetike, sidoqoftë termi më i përdorur në literaturë është termi „Krimi kibernetik”. Ky term

---

<sup>4</sup> Po aty fq.15.

<sup>5</sup> Leukfeldt Rutger, The human Factor in cybercrime and cybersecurity, Netherlands, 2017, ISBN 978-94-6274-706-7, fq. 19.

<sup>6</sup> Merriam Webster dictionary, 1828, <https://www.merriam-webster.com/dictionary/cybercrime> (qasja e fundit më 05.06.2021).

është preferuar gjithashtu nga Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik, andaj i njëjti është përdorur edhe në këtë temë.

Sipas Konventës së Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik, e cila ndryshe njihet edhe si Konventa e Budapestit e miratuar në vitin 2001, krimi kibernetik është *çdo veprim kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë të të dhënave dhe sistemeve kompjuterike*, përfshirë: hyrja e paligjshme, përgjimi i paligjshëm, ndërhyrja tek të dhënat, ndërhyrja në sistem, keqpërdorimi i pajisjeve, falsifikimi lidhur me kompjuterin, mashtrimi lidhur me kompjuterin, veprat penale lidhur me pornografinë fëmijërore, veprat penale në lidhje me shkeljet e të drejtës së autorit dhe të drejtat e ngjashme<sup>7</sup>.

Gjatë Kongresit të 10-të të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e të dënuarve, u përkufizuan dy nocione lidhur me krimin kibernetik. Krimi kibernetik në kuptimin e ngushtë, që nënkupton çdo sjellje e paligjshme e kryer me anë të mjeteve elektronike që atakojnë sigurinë e sistemeve kompjuterike dhe të dhënave të përpunuara prej tyre. Nga ana tjetër, krimi kibernetik në kuptimin e gjërë nënkupton, çdo sjellje e paligjshme e kryer me anë të një sistemi kompjuterik ose rrjeti, duke përfshirë krime të tilla si posedimi i paligjshëm dhe ofrimi ose shpërndarja e informacionit me anë të një sistemi kompjuterik ose rrjeti<sup>8</sup>.

Sigurisht, përkufizimet që mund të bëhen në lidhje me krimin kibernetik nuk janë të kufizuara në përkufizimet e dhëna më sipër. Shumë burime dhe autorë të tjerë kanë bërë përkufizime të ndryshme alternative për krimin kibernetik. Megjithëse përkufizimi i krimit kibernetik është i rëndësishëm për sa i përket dallimit të tij nga krimet tjera, luftimit të këtij krimi dhe zhvillimit të politikave dhe strategjive të ndryshme në këtë drejtim.

---

<sup>7</sup> Convention on Cybercrime (CETS No.185), Budapest, 2001, <https://rm.coe.int/1680081561> (qasja e fundit më 05.06.2021).

<sup>8</sup> 10th UN Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders, 2000, A/CONF.187/10, fq.6-24.

### **3. Karakteristikat e krimit kibernetik**

Në luftën kundër krimit kibernetik është e domosdoshme të përcaktohen karakteristikat specifike të këtij krimi, të cilat e dallojnë atë nga krimet tjera tradicionale. Shqyrtimi i këtyre veçorive gjithashtu është i rëndësishëm sa i përket sigurisë kibernetike.

#### **3.1. Kufijtë e krimit kibernetik**

Karakteristika kryesore e krimit kibernetik është ana e tij „pa kufij” (borderless). Ndryshe nga krimi tradicional, krimi kibernetik nuk mund të kufizohet nga kufijtë kombëtarë, ekonomikë dhe socialë. Për të qenë më specifik, krimi kibernetik mund të kryhet nga një kriminel në shumë juridiksione të ndryshme në botë. Prandaj, është pothuajse e pamundur që një vend të luftojë këtë krim vetëm me anë të ligjeve kombëtare. Lufta kundër këtij krimi kërkon një bashkëpunim ndërkombëtar si dhe mjete të përbashkëta ndërkombëtare<sup>9</sup>.

Tek krimet tradicionale për nga natyra e tyre, zakonisht kryerësi pritët të jetë në, ose afër vendit të ngjarjes, ku edhe gjenden gjurmët e veprës penale. Mirëpo, vendi i ngjarjes për një kriminel kibernetik nuk do të thotë asgjë. Të gjitha llojet e krimeve kibernetike mund të kryhen në distancë, pa pasur nevojë që kryerësi dhe viktima të gjenden në një ambient të përbashkët, madje në disa rrethana, as edhe të kenë kontakt me njëri-tjetrin<sup>10</sup>.

#### **3.2. Hetimi i krimit kibernetik**

Një ndër karakteristikat e krimit kibernetik është edhe hetimi dhe zbulimi i tyre. Zbulimi dhe të provuarit e krimit kibernetik është e vështirë dhe tejet e ndërlikuar. Ndërhyrjet e pa autorizuara në sistemet kompjuterike mund të kryhen pa lënë gjurmë individuale nga ana e kryerësit dhe se veprimi kryhet në një vend, dëmi shkaktohet në një vend tjetër kudo në botë.<sup>11</sup>

---

<sup>9</sup> Wall David, Cybercrimes: New Wine, No Bottles?, Dartmouth Publishing Company, 2003, fq 5.

<sup>10</sup> Nyman Gibson Miralis, Why is cybercrime regarded as a borderless crime?, 2021, <https://ngm.com.au/cybercrime/borderless-crime> (qasja e fundit më 07.06.2021).

<sup>11</sup> Vula Veton & Ademi Mensut, Krimi Kompjuterik, Prishtinë, 2018, fq.52.

Karakteristika tjetër tek hetimi i krimeve kibernetike është edhe natyra e provave. Ndryshe nga krimi klasik ku si prova të pakontestueshme janë provat materiale që mbartin gjurmë të kryerësit dhe viktimës dhe në fakt vërtetojnë se kryerësi e ka kryer krimin, dmth. vërtetojnë faktin që kryerësi dhe viktimja në një kohë të caktuar ishin në vendin specifik ku ka ndodhur krimi. Mirëpo, prova të tilla materiale në krimin kibernetik nuk është e mundur të zbulohen.

Si prova të krimit kibernetik paraqiten provat digjitale. „Me provë digjitale nënkuptohet informacioni i cili është i deponuar ose i bartur në formë digjitale i cili mund të shfrytëzohet edhe në procesin gjyqësor”.<sup>12</sup> Forma digjitale sipas natyrës së saj nënkupton atë se këtu bëhet fjalë për ndonjë pajisje elektronike apo magnetike dhe aty mund të jenë të dhënat e deponuara në memorie, hard disk, flash kartela etj<sup>13</sup>.

Hetuesit e krimit kibernetik duhet të jenë ekspertë në shkencën kompjuterike, duke kuptuar jo vetëm softuerin, skedarin dhe sistemet operative, por edhe mënyrën e funksionimit të rrjeteve dhe pajisjeve. Ata duhet të posedojnë aftësi të mjaftueshme dhe profesionale për të përcaktuar se si ndodhin ndërveprimet midis këtyre përbërësve, për të marrë një pamje të plotë të asaj që ka ndodhur, ku ka ndodhur, kur ka ndodhur, kush është kryerësi dhe nga ana tjetër, se si viktimat mund të mbrojnë veten në të ardhmen kundër këtyre llojeve të kërcënimeve kibernetike.<sup>14</sup>

### **3.3. Anonimiteti i krimit kibernetik**

Roli i anonimitetit në hapësirën kibernetike, lejon që kriminelët të jenë në gjendje të vepronë në hapësirën kibernetike relativisht të pazbuluar nga autoritetet. Fakti që krimet kibernetike kryhen në distancë dhe në një mjedis elektronik, mundësohet që këto veprime të kryhen më shpejt, më lehtë, në mënyra të ndryshme dhe nga këndvështrimi i kriminelëve në mënyrë të konsiderueshme anonime, sepse teknologjia moderne e informatikës ofron kushte

---

<sup>12</sup> Po aty, fq.63.

<sup>13</sup> Po aty, fq.63.

<sup>14</sup> Borges Esteban, Cyber Crime Investigation Tools and Techniques Explained, Security Trails, 2020, <https://securitytrails.com/blog/cyber-crime-investigation> (qasja e fundit më 15.06.2021)

ideale për autorët për të fshehur aktivitetet e tyre kriminale. Ajo që është karakteristike edhe tek viktimat që kur zbulojnë se kanë qenë viktimat të krimit kibernetik, ata shpesh nuk e denoncojnë rastin tek autoritetet kompetente.<sup>15</sup>

Për arsye të anonimitetit të krimeve kibernetike dhe vështirësisë që paraqiten tek mbledhja e të dhënave të sakta mbi përhapjen e krimit kibernetik, numri i errët është shumë i lartë.

#### **4. Tipologjia krimit kibernetik**

Krahas karakteristikave të lartë përmendura të krimit kibernetik, si karakteristikë e rëndësishme që dallojnë krimet kibernetike nga krimet tjera tradicionale, janë edhe ndryshimet në mënyrën e kryerjes së këtyre krimeve.

Sa i përket mënyrës së kryerjes të krimit kibernetik, autori V. Vula, në librin e tij: „Krimi Kompjuterik”, potencon se: „Krimi kompjueterik është një formë e veçantë e kriminalitetit, në të cilën kompjueteri paraqitet si mjet për kryerjen e veprimit ilegal (modus operandi) apo si objekt sulmi, i drejtuar nga personat të cilët posedojnë njohuri dhe prirje të veçanta për sistemet kompjueterike, me qëllimin që vetes dhe të tjerëve t’u sjellin përfitime.”<sup>16</sup>

Nga sa u tha më lartë, mund të kuptohet se krimet kibernetike mund të klasifikohen, gjegjësisht krimet kibernetike mund të kryhen në dy mënyra, ku: a) *Sistemet kompjueterike paraqiten si objekt sulmi*, me ç’rast kompjueterët dhe informacionet e vendosura në të bëhen caqe të sulmeve nga ana e kriminelëve kibernetikë, të tilla si phishing, spamming, hacking; dhe kur b) *Sistemet kompjueterike përdoren si mjet për kryerje të krimit*, ku kriminelët kibernetikë i shfrytëzojnë kompjueterët për të kryer krime, si pornografia fëmijërore, vjedhjet, mashtrimet. Andaj në vazhdim do të paraqiten format e krimit kibernetik varësisht tipologjisë së tyre.

---

<sup>15</sup> Bray Jesse D., Anonymity, Cybercrime, and the Connection to Cryptocurrency, Eastern Kentucky University, 2016, fq 14. <https://encompass.eku.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1342&context=etd> (qasja e fundit më 20.06.2021).

<sup>16</sup> Vula Veton& Ademi Mensut, Krimi Kompjuterik, Prishtinë, 2018, fq.14.



## 5. Format e krimit kibernetik

### 5.1. Hakingu

Një ndër format më të njohura të krimit kibernetik është Hakingu. „Hakingu është vepër penale e drejtuar kundër sistemeve kompjuterike me qëllim të shkatërrimit, modifikimit dhe përgjimit të sistemeve informatike”.<sup>17</sup> Kjo vepër karakterizohet me qasjen e pa autorizuar në sistemet e huaja kompjuterike, e cila shikuar në kuptimin klasik, do të thotë ndërhyrje e dhunshme në objektet e huaja. Kur sulmuesi (hakeri) kyçet në sistemin e huaj kompjuterik, ai mund t'i shfrytëzojë shumë mangësi që janë prezente në atë sistem kompjuterik, me qëllim që vetit t'i krijojë mundësi për qasje në të gjitha bazat e të dhënave të vendosura në atë sistem. Me hyrjen në sistemin e huaj kompjuterik, hackeri mund t'i transferojë të gjitha të dhënat në kompjuterin e tij, mund të bëjë modifikimin e të dhënave sistematike, që për të ardhmen t'i sigurojë vetes hyrje të papenguar dhe njëkohësisht t'i fsheh gjurmët e hyrjes dhe qëndrimit në atë sistem kompjuterik.<sup>18</sup>

### 5.2. Viruset kibernetike

Viruset kibernetike janë një lloj programi, i cili përdoret me qëllim që t'i infektoj programet tjera. Viruset kanë për qëllim shkatërrimin e të dhënave, dëmtimin e skedarëve, ngadalësimin e sistemit kompjuterik dhe të shkaktojnë probleme të tjera në sistemin kompjuterik. Viruset mund të merren përmes mënyrave të ndryshme, si për shembull përmes postave elektronike me një bashkëngjitje (attachment) të dëmshme, dhe me hapjen e skedarit pa dijeni, virusi i kompjuterit shpërndahet në kompjuterin tuaj, ose duke shkarkuar fajlla nga interneti, ose përmes njësive të memories si disketa, CD, USB etj.<sup>19</sup>

---

<sup>17</sup> Po aty, fq.134.

<sup>18</sup> Po aty, fq.135.

<sup>19</sup> Malware bytes, What is a computer virus?, <https://www.malwarebytes.com/computer-virus> (qasja e fundit më 20.06.2021)

### 5.3. Mashtrimi kibernetik

Mashtrimi kibernetik konsiderohet si një ndër format më të rrezikshme të kriminalitetit kibernetik. Mashtrimi kibernetik, ndryshe mund të quhet edhe mashtrimin në internet, dhe definohet si: „përdorimi i një kompjuteri ose sistemi kompjuterik për të atakuar një kompjuter tjetër me qëllim për ta ndryshuar, dëmtuar ose çaktivizuar atë”.<sup>20</sup>

### 5.4. Fishingu

Fishingu është një nga veprat më të shpeshta të mashtrimeve kibernetike. Fishingu është një lloj sulmi në internet, që kryhet me qëllim për të vjedhur të dhënat e kartelave kreditore. Në shumicën e rasteve, fishingu ndodh kur një sulmues, duke u maskuar si një kompani e besuar, mashtron një viktimë për të hapur një email, mesazh të çastit ose mesazh me tekst. Viktimat në shumicën e rasteve besojnë se këto janë të ligjshme, dhe u japin të dhënat e tyre personale, të tilla si fjalëkalimet, kartat e kreditit dhe numrat e llogarisë bankare.<sup>21</sup>

### 5.5. Falsifikimi kibernetik

Falsifikimi me anë të kompjuterëve nënkupton shfrytëzimin e kompjuterit si mjet manipulimi me qëllim të kryerjes së falsifikimit, shpesh duke përdorur njësitë hyrëse (skedarët). Kështu dokumenti, i cili dëshirohet të falsifikohet vendoset në kompjuter dhe pastaj me ndihmën e programeve iu ndërrohet forma dhe përmbajtja e tyre. Ekzistojnë dy lloje të manipulimeve të falsifikimit kompjuterik, kur: kompjuteri përdoret për falsifikimin e dokumenteve të huaja në formë digjitale, ose kur kompjuteri përdoret për qëllime të krijimit të atyre dokumenteve. Si forma më tipike të falsifikimit vlen të përmenden: falsifikimi i dokumenteve, si diplomat, certifikatat, vërtetimet etj.; falsifikimi i shenjave për vlera; falsifikimi i shenjave për shenjimin e mallrave; falsifikimi i parave, nënshkrimeve; vulave, letrave me vlerë.<sup>22</sup>

---

<sup>20</sup> Computer and internet fraud, 2021, <https://www.impactlaw.com/criminal-law/white-collar/computer-internet-fraud> (qasja e fundit më 20.06.2021)

<sup>21</sup> Kunz Michael & Wilson Patrick, Computer Crime and Computer Fraud, University of Maryland Department of Criminology and Criminal Justice, 2004 Fq.14.

<sup>22</sup> Vula Veton & Ademi Mensut, Krimi Kompjuterik, Prishtinë, 2018, fq.103-104.

## 5.6. Sabotazhi kibernetik

Sabotazhi kibernetik është një ndër krimet më të rrezikshme që mund të kryhet në hapësirën kibernetike. Me sabotazhin kibernetik nënkuptojmë veprimet kriminale që atakojnë sistemet kompjuterike ose rrjetet me qëllim që të pengohet shfrytëzimi i tyre. Ky krim kryhet duke shkatërruar dhe dëmtuar pajisjet kompjuterike.<sup>23</sup>

## 5.7. Bullizmi kibernetik

Me bullizmin nënkuptojmë sjelljet agresive, të dëmshme dhe të përsëritura duke përfshirë dhunën psikike dhe fizike ndërmjet personave. Bullizmi përfshin veprime të tilla si: goditjet, rrahjet, fyerjet, ngacmimet fizike ose psikike, përjashtimi nga shoqëria etj.<sup>24</sup>

Me zhvillimin e teknologjisë, bullizmi tradicional është transferuar në internet dhe kështu ka lindur e ashq. bullizmi kibernetik. Bullizmi kibernetik definohet si përdorim i qëllimshëm dhe i përsëritur i mjeteve elektronike të komunikimit për të kërcënuar, turpëruar, poshtëruar një apo më shumë persona. Bullizmi në internet mund të kryhet në forma të ndryshme. Këtu vlen të përmendet: postimi i informacioneve të ndjeshme, private ose thashethemeve; dërgimi i mesazheve kërcënuese, postimi i sekreteve në rrjete sociale, postimi dhe shpërndarja e fotografive personale (intime) pa dëshirën e personit, përjashtimi nga grupet në rrjete sociale etj.<sup>25</sup>

## 5.8. Pornografia kibernetike fëmijërore

Pornografia kibernetike fëmijërore, e cila është edhe objekt studimi i këtij punimi, konsiderohet si një ndër format më të rrezikshme të krimit kibernetik dhe të shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Veçanërisht në dy dekadat e fundit, për shkak të zhvillimit të teknologjisë së informatikës, pornografistët kanë gjetur një vend të përshtatshëm për të ndarë imazhe të

---

<sup>23</sup> Military News, Cyber sabotage, 2008, <https://www.military.com/defensetech/2008/02/06/cyber-sabotage> (qasja e fundit më 25.06.2021)

<sup>24</sup> Health Resources and Services Administration, Cyberbullying, <https://www.dinwiddie.k12.va.us/app/uploads/2018/12/Cyberbullying.pdf> (qasja e fundit më 26.06.2021)

<sup>25</sup> TOJET: The Turkish Online Journal of Educational Technology – January 2016, volume 15 issue 1, Prevalence and Impact of Cyberbullying in a Sample of Indonesian Junior High School Students, fq.83.

tmerrshme të fëmijëve të abuzuar seksualisht. Imazhe të tilla të shfrytëzimit seksual, shkaktjnë ndikime serioze fizike dhe psikologjike dhe kërcënojnë jetën e fëmijëve.

## KAPITULLI I DYTË

### Pornografia fëmijërore si formë e krimit kibernetik

#### 1. Evolucioni i pornografisë fëmijërore

Fëmijët janë trajtuar dhe janë shikuar si objekte seksuale shumë kohë para shpikjes së internetit.<sup>26</sup> Portretet piktorore dhe të shkruara të fëmijëve si objekte seksuale, kanë ekzistuar edhe mijëra vitesh më parë. Në epokën moderne, natyra dhe disponueshmëria e pornografisë fëmijërore është nxitur nga përparimet teknologjike, së pari me shpikjen e kamerës në fillim të shekullit XIX dhe së fundmi me ardhjen e internetit dhe teknologjive digjitale kah fundi i shekullit XX. Në veçanti, interneti ka transformuar prodhimin, shpërndarjen dhe shfrytëzimin e pornografisë fëmijërore, duke rritur në mënyrë eksponenciale sasinë e materialeve pornografike dhe numrin e njerëzve që i shfrytëzojnë ato materiale. Para Internetit, materialet me përmbajtje pornografike fëmijërore janë shpërndarë fshehurazi në formë hard-copy në mes grupeve relativisht të vogla të përdoruesve të dedikuar. Kualiteti i materialeve ka qenë i dobët dhe mjaft të shtrenjtë, diapazoni i kufizuar dhe rrjetet e shpërndarjes kanë qenë jo të besueshme.<sup>27</sup>

Deri në vitet e 70'ta të shekullit të kaluar, pornografia fëmijërore nuk është konsideruar si krim. Përfshirë edhe në shtetet më demokratike në botë, si Danimarka, Suedia dhe Holanda, filmat, revistat dhe librat që përmbajnë imazhe pornografike të të miturve janë shitur legalisht. Në fund të kësaj dekade, kryesisht në vitin 1977, u raportuan më shumë se 2 milion fëmijë amerikanë që kishin qenë viktima të pornografisë, dhe përfitimet ekonomike nga kjo industri gjeneruan mbi 5 miliard dollarë në vit.<sup>28</sup>

---

<sup>26</sup> Kathryn C. Seigfried, Richard W. Lovely, Marcus K. Rogers - Online Child Pornography Behavior, New York, 2008, fq.286.

<sup>27</sup> Wortley R. (2014) Child Pornography. In: Bruinsma G., Weisburd D. (eds) Encyclopedia of Criminology and Criminal Justice. Springer, New York, NY. [https://doi.org/10.1007/978-1-4614-5690-2\\_105](https://doi.org/10.1007/978-1-4614-5690-2_105)

<sup>28</sup> Laura Negrodo and Óscar Herrero, Child pornography on the internet, Madrid, 2016. Vol. 37(3),fq.217. <https://www.researchgate.net/publication/309921787>

Për shkak të ndikimit negativ që kishte prodhimi i këtyre materialeve tek fëmijët viktima, opinioni publik kërkoi një ndryshim legjislativ, kështu që në vitin 1978 u miratuan ligjet e para specifike kundër pornografisë fëmijërore. Me inkriminimin e kësaj vepre si vepër penale, mendohet që gjatë viteve në vijim qasja në materiale me përmbajtje të pornografisë fëmijërore është zvogëluar.<sup>29</sup>

Me shfaqjen e internetin në vitet 90'ta, dhe zhvillimi i tij i jashtëzakonshëm gjatë këtij shekulli, e ndryshoi këtë dukuri kriminale në mënyrë drastike. Interneti, në fakt, nuk është vetëm një mjet për transmetimin e imazheve(fotografive) dhe videove me përmbajtje pornografike, por përkundrazi e luan rolin kryesor në fenomenin e pornografisë fëmijërore, duke lehtësuar prodhimin, shpërndarjen dhe posedimin e saj. Kështu teknologjia informatike e shndërroi pornografinë fëmijërore klasike në pornografinë fëmijërore kibernetike, duke e lehtësuar kryerjen e saj dhe njëkohësisht duke e vështirësuar zbulimin dhe ndjekjen e saj.

## **2. Kuptimi i pornografisë fëmijërore**

Pornografia kibernetike fëmijërore është një problem gjithnjë e më i dukshëm në shoqërinë e sotme. Me rritjen e përdorimit të Kompjuterit Personal (PC) dhe telefonave të mençur, si dhe me qasje të menjëhershme në World Wide Web gjatë dekadës së fundit, pornografët e fëmijëve kanë gjetur një vend të përshtatshëm për të ndarë incizime apo fotografi të tmerrshme të fëmijëve të abuzuar seksualisht.

Përkufizimet ligjore të pornografisë fëmijërore ndryshojnë sipas legjislacionit të çdo shteti. Kështu, përkufizimet ligjore të këtij krimi janë shtjelluar në kapitullin e tretë, duke analizuar kuptimin e tij sipas akteve ndërkombëtare si dhe në kapitullin e katërt sipas legjislacionit të disa shteteve. Duke e marrë parasysh se përkufizimet ligjore të pornografisë fëmijërore, ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis juridiksioneve, për parandalimin dhe luftimin e këtij krimi është e nevojshme që të studiohet më gjerësisht se çfarë nënkupton në të vërtetë ky krim.

---

<sup>29</sup> Po aty, fq.118.

Pornografia, ndryshe e njohur edhe si „porno” definohet si çdo lloj materiali me aktivitet seksual ose me nuditet që si qëllim kryesor ka zgjimin e epshit seksual.<sup>30</sup>

Autorët Peter dhe Valkenburg e përkufizojnë pornografinë si fotografi ose video-klipe, të krijuara në mënyrë profesionale ose të krijuara nga përdoruesit, që synojnë të zgjojnë epshin seksual të shikuesve. Këto përfshijnë video dhe fotografi që përshkruajnë aktivitetet seksuale të tilla si masturbimi, si dhe marrëdhëniet seksuale në një mënyrë të hapur dhe shpesh të inçizuar nga afër ku në fokus kryesor janë organet gjenitale.<sup>31</sup>

Ndryshe nga pornografia me të rritur e cila në shumicën e shteteve është legale<sup>32</sup>, pornografia që përfshin fëmijët konsiderohet si një ndër krimet më të rënda ngase cenon integritetin dhe dinjitetin seksual të fëmijëve. Falë mundësive që ofron interneti dhe karakteristikave të krimit kibernetik, kiber-pornografia fëmijërore është vështirë për të kontrolluar dhe parandaluar. Nga ana tjetër, fakti që ende shumë shtete në botë nuk e kanë inkriminuar pornografinë fëmijërore si vepër penale<sup>33</sup>, e bën më të vështirë parandalimin e këtij krimi.

### 3. Klasifikimi dhe llojet e pornografisë fëmijërore

Në literaturë ekzistojnë klasifikime të ndryshme për pornografinë fëmijërore. Ndër klasifikimet më të njohura mund të përmenden klasifikimet në vazhdim:

1). Klasifikimi i përgjithshëm i pornografisë fëmijërore.

- Aktivitetet seksuale që përfshijnë të rriturit dhe fëmijët;
- Aktivitetet seksuale që përfshijnë vetëm fëmijët.

2). Klasifikimi i pornografisë fëmijërore sipas përbërjes së imazhit pornografik.

- Imazhe të organeve gjenitale të fëmijëve;

---

<sup>30</sup>Stanford Encyclopedia of Philosophy, Pornography and Censorship, 2012, <https://plato.stanford.edu/entries/pornography-censorship/#WhaPor> (qasja e fundit më 02.07.2021).

<sup>31</sup>Jochen Peter & Patti M. Valkenburg, Adolescents and Pornography: A Review of 20 Years of Research, The Journal of Sex Research, 2016, Fq 510.

<sup>32</sup>World Population Review, Countries Where Porn Is Illegal 2021, <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/countries-where-porn-is-illegal> (qasja e fundit më 02.07.2021).

<sup>33</sup>Se cilat shtete nuk e kanë inkriminuar është shjelluar në kapitullin e katërt.

- Imazhet të cilat shfaqin të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve duke përfshirë edhe foshnjët, si përdhunimi brutal anal ose vaginal, skllavërinë seksuale, seksin oral si dhe marrëdhënien seksuale me kafshë.<sup>34</sup>

Zhvillimet e fundit në teknologjinë kompjuterike, kanë mundësuar pornografët për të krijuar imazhe pornografike të fëmijëve që duken se janë të përfshirë në aktivitete seksuale pa pasur nevojë për një fëmijë të vërtetë për krijimin e imazheve të tilla. Bëhet fjalë për **„pornografinë e krijuar nga kompjuteri“**.<sup>35</sup>

Një ndër format më të njohura të pornografisë së krijuar nga kompjuteri është **„pornografia morphing“**. Ky lloj i pornografisë krijohet duke transformuar fotografinë e një të miturit tek fotografia e të një rrituri, i cili është angazhuar në aktivitete eksplicite seksuale. Pra në aktivitetet seksuale të këtij lloji të pornografisë, nuk përfshihet i mituri, por fotografitë e të miturve modifikohen në imazhe të tilla pornografike. Teknika me të cilën krijohen imazhe të tilla quhet teknika „morphing“. Morfimi i imazheve arrihet me prerjen e pjesëve të ndryshme të trupit të fëmijëve nga fotografitë të pafajshme të tyre dhe ngjitja e atyre pjesëve në fotografitë ku janë të pranishëm të rriturit (cut-paste).<sup>36</sup>

Fotografitë e pafajshme të fëmijëve mund të arrihen nga burime të ndryshme. Burimi më i zakonshëm ku mund të arrihen fotografitë e fëmijëve pa dyshim janë rrjetet sociale. Në një studim australian është zbuluar se afërsisht gjysma e imazheve të shpërndara në web-faqet pedofilike janë marrë kryesisht nga rrjetet sociale dhe blogjet familjare.<sup>37</sup>

Prindërit shpesh ndajnë fotografitë e fëmijëve të tyre në mënyra të ndryshme në rrjete sociale. Edhe pse prindërit i postojnë fotografitë e pafajshme të fëmijëve të tyre pa asnjë qëllim të keq, gjithsesi ato mund keqpërdoren nëse shihen nga e një pedofili. Pa dijeninë e prindërve,

<sup>34</sup> Uzunay Yusuf & Koçak Mustafa, Child Pornography on Internet and the Challenges in Combating, Polis Bilimleri Dergisi Cilt: 7(l) Turkish Journal of Police Studies Vol: 7 (1), fq.105.

<sup>35</sup> Solowey Rikki, , A Question of Equivalence: Expanding the Definition of Child Pornography to Encompass “Virtual” Computer-Generated Images, Vol.4 2002, fq 161.

<sup>36</sup> Caleb Beacham, Metamorphosis: Changing Oklahoma Law to Protect Children from Morphed Child Pornography, 55 Tulsa L. Rev. 311 (2020).fq. 316.

<sup>37</sup> Stacey B. Steinberg, Sharenting: Children's Privacy in the Age of Social Media, 66 Emory L.J. 839 (2017) Fq.881.



pedofilët mund ti ruajnë imazhet e fëmijëve të tyre dhe më vonë ti përdorin ato për të krijuar pornografi morphing me fëmijë.

Një lloj tjetër i pornografisë së kryer nga kompjuteri është edhe „**pornografia virtuale fëmijërore**”. Pornografia virtuale nuk është e ngjashme me llojet tjera të pornografisë fëmijërore sepse në pornografinë virtuale fëmijërore nuk përfshihet një fëmijë i vërtetë gjatë kryerjes së aktiviteteve seksuale e as që shfaqen organet gjenitale të fëmijëve të vërtetë.

Në vend që të përdoret një fëmijë të vërtetë, imazhet pornografike krijohen plotësisht nga kompjuteri. Kështu me përparimin e teknologjisë imazhet e tilla bëhen gjithnjë e më realiste dhe nuk dallohen fare nga fëmijë të vërtetë. Ky lloj i pornografisë në esencë quhet „pornografi fiktive fëmijërore” sepse këtu përfshihen fëmijë virtual (jo të vërtetë) të krijuara nga kompjuteri, të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme seksuale.<sup>38</sup>

#### **4. Format e manifestimit të pornografisë fëmijërore**

Pornografia fëmijërore mund të kryhet në forma të ndryshme. Për parandalimin e këtij krimi është e domosdoshme që të përcaktohen të gjitha aktet me të cilat mund të kryhet ky krim. Si forma të manifestimit të pornografisë fëmijërore konsiderohet:<sup>39</sup>

**a) Prodhimi (Production)**- Me prodhimin nënkuptojmë krijimin e imazheve pornografike. Edhe pse vazhdimisht prodhohen materiale të reja pornografike, ende shumë imazhe që qarkullojnë në internet janë me dekada të vjetra, të marra nga revista dhe filma të mëparshëm. Imazhet pornografike mund të krijohen në mënyrë profesionale nga personat që merren enkas me këtë profesion ose imazhet e tilla mund të krijohen në mënyrë amatore, me anë të pajisjeve elektronike të regjistrimit, si kamerat digjitale dhe kamerat në internet (web-cams) të cilat mundësojnë krijimin e imazheve të cilësisë së lartë të bëra në shtëpi (home made).

---

<sup>38</sup> Caleb Beacham, *Metamorphosis: Changing Oklahoma Law to Protect Children from Morphed Child Pornography*, 55 *Tulsa L. Rev.* 311 (2020), fq.316.

<sup>39</sup> Richard Wortley, Stephen Smallbone, *Child Pornography on the Internet*, U.S. Department of Justice, Office of Community Oriented Policing Services (COPS Office). 2006, ISBN: 1-932582-65-7, fq. 10.

**b) Distribuimi** (*Distribution*)- Distribuimi përfshin ngarkimin (uploading) dhe shpërndarjen e imazheve pornografike. Distribuimin mund ta kryejnë grupet pedofilike (pedophile rings) ose grupe të krimit të organizuar për përfitime financiare. Imazhet pornografike me fëmijë në internet, mund të ngarkohen në forma të ndryshme, si për shembull ato mund të ngarkohen në uebfaqe, mund të shkëmbehen përmes postës elektronike, mesazheve, tabelave të njoftimit (bulletin boards), grupe të lajmeve (news groups), dhoma të bisedave (chat rooms), dhe rrjeteve kompjuterike (P2P).

**c) Shkarkimi** (*Downloading*)- Shkarkimi nënkupton aksesin në pornografinë fëmijërore përmes internetit dhe ruajtjen e saj. Shumica e pornografisë fëmijërore shkarkohet përmes grupeve të lajmeve dhe dhomave të bisedave. Pra, është vërtetuar se pornografia me fëmijë është relativisht e rrallë në zona të hapura të internetit dhe ata që kërkojnë të gjejnë imazhe të tilla, duhet të kenë aftësi të mira kompjuterike se ku të kërkojë ose të regjistrohen në grupe pedofilike të krijuara enkas për shikimin dhe shkarkimin e imazheve pornografike me fëmijë. Regjistrimi në këto grupe bëhet me pagesë dhe për kyçjen në to kërkohet fjalëkalim.

Prodhim, distribuimi dhe shkarkimi janë tre format themelore të manifestimit të pornografisë fëmijërore, që duhet të jenë të inkriminuara si vepër penale në çdo kod penal. Krahas këtyre formave, duhet të inkriminohen edhe akte të tjera që lidhen me pornografinë fëmijërore, të tilla si: shikimi; printimi; publikimi; transmetimi apo dërgimi; vënia në dispozicion; shitja; importimi dhe eksportimi si dhe posedimi i pornografisë fëmijërore.

## **5. Kryerësit e pornografisë fëmijërore**

### **5.1. Tipologjia e kryerësve**

Njohja e tipologjisë së kryerësve të pornografisë fëmijërore, është me rëndësi jetike për të kuptuar se kush janë viktimizuesit e fëmijëve. Duke i marrë parasysh format e kryerjes së

pornografisë fëmijërore, autori Tony Krone ka bërë klasifikimin e kryerësve në bazë të motivit dhe natyrës së abuzimit të fëmijëve. Kështu sipas Krone's ekzistojnë disa lloje të kryerësve, si<sup>40</sup>:

**1. Shfletuesi (Browser)**- është ai i cili has pornografi me fëmijë pa dashje duke u përgjigjur ndaj spamëve, ose duke klikuar aksidentalisht në ndonjë uebfaqe të dyshuar, por më pas vendos ta ruajë materialin me vetëdije. Natyra e abuzimit është indirekte.

**2. Kërkuesi (Trawler)**- është ai i cili vazhdimisht kërkon pornografi me fëmijë duke përdorur shfletues të hapur. Natyra e abuzimit është indirekte.

**3. Koleksionisti (Collector)**- është ai i cili mbledh numër të konsiderueshëm imazhesh pornografike me fëmijë, duke blerë, shkarkuar ose shkëmbyer. Natyra e abuzimit është indirekte.

**4. Joshësi (Groomer)**- është ai i cili hyn në kontakt me fëmijë (kryesisht përmes rrjeteve sociale, dhomave të bisedave, grupeve të lajmeve etj.), me qëllim të abuzimit seksual dhe krijimit të materialeve pornografike. Natyra e abuzimit është direkte.

**5. Abuzuesi fizik (Physical abuser)**- është ai i cili është përfshirë në aktivitetin seksual në materialin pornografik. Abuzuesi fizik krijon pornografi me fëmijë vetëm për të plotësuar dëshirat e tij seksuale, pa qëllim të distributimit apo shpërndarjes së saj me të tjerët. Natyra e abuzimit është direkte.

**6. Prodhuesi (Producer)**- është ai i cili regjostron (inçizon) abuzimin e vet ose atë të të tjerëve ose nxit fëmijët të paraqesin imazhe të vetes. Prodhuesi krijon imazhe pornografike me qëllim distributimi. Natyra e abuzimit është direkte.

**7. Distributori (Distributor)**- është ai i cili i shpërndan materialet pornografike. Natyra e abuzimit është indirekte.

---

<sup>40</sup> Krone Tony, A typology of online child pornography offending, Australian Institute of Criminology, 2004,. Fq. 4.

## 5.2. Karakteristikat e kryerësve

Një koncept tjetër që duhet theksuar dhe analizuar lidhur me pornografinë fëmijërore është edhe „parafilia”. Parafilia definohet si një lloj çrregullimi mendor të preferencave seksuale.<sup>41</sup>

Manuali aktual diagnostikues dhe statistikor i çrregullimeve mendore (DSMIV-TR) nuk kategorizon as varësinë seksuale, as obsesionin seksual, si një çrregullim mendor.<sup>42</sup> Mirëpo, kur veprimet e një individi nxiten nga prania e dëshirave të përsëritura, jonormale seksuale p.sh., nga dëshira për të parë në mënyrë të përsëritur pornografinë fëmijërore, ai individ mund të diagnostikohet me një "Çrregullim Parafilik ". Termi „Parafilia” në këtë kontest përdoret për të nënkuptuar praninë e një lloji anomalie seksuale, me të cilën një person përjeton nxitje intensive dhe të përsëritura, në lidhje me shikimin e imazheve pornografike me fëmijë.<sup>43</sup>

Duke e marrë parasysh moshën e fëmijëve, dallohen 3 lloje të parafilisë:<sup>44</sup>

- a) Pedofilia- është një çrregullim psikiatrik në të cilin një i rritur ka dëshirë apo preferencë seksuale për fëmijët para pubertetit;
- b) Hebefilia- preferencë seksuale për fëmijët në adoleshencën e hershme, midis moshës 11 dhe 14;
- c) Efebofilia- i referohet një tërheqjeje për adoleshentët rreth moshës 15 deri në 18 vjeç.

Nga sa u tha më lartë mund të konkludohet që, shikuesit e imazheve pornografike me fëmijë mund të diagnostifikohen në njërin prej llojeve të parafilisë, varësisht preferencës seksuale të personit sa i përket moshës së fëmijës. Mirëpo, duke e marrë parasysh tipologjinë e kryerësve të pornografisë fëmijërore, jo të gjithë prej tyre kanë dëshira apo preferenca seksuale për fëmijët. Prodhuesit profesionalë që krijojnë imazhe pornografike si dhe distributorët që i

---

<sup>41</sup> <https://www.dictionary.com/browse/paraphilia> (qasja e fundit 20.07.2021)

<sup>42</sup> American Psychiatric Association (2000). Diagnostic and statistical manual of mental disorders, fourth edition, text revision, Washington, D. C.

<sup>43</sup> Fred S. Berlin, Denise Sawyer, Potential Consequences of Accessing Child Pornography Over the Internet and Who is Accessing It, 2012, 1532-5318 online DOI: 10.1080/10720162.2012.660429, fq.37.

<sup>44</sup> Psychology Today, 2021 Sussex Publishers, LLC <https://www.psychologytoday.com/us/basics/hebephilia> (qasja e fundit më 22.07.2021).

shpërndajnë ato, nuk kanë interes seksual për fëmijët, por i krijojnë dhe i shpërndajnë ato për përfitime financiare.

Me rëndësi është të analizohet edhe lidhja apo *raporti mes veprës penale të dhunimit seksual të fëmijës dhe pornografisë fëmijërore*. Sipas një studimi të kryer nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë, një në tetë nga kryerësit të pornografisë fëmijërore, më parë kanë qenë të dënuar për sulm seksual ndaj fëmijës. Mirëpo, duke i marrë parasysh edhe veprat penale të pazbuluara të dhunimeve seksuale, kryerësit e pornografisë fëmijërore janë nënshtruar ekzaminimit poligrafik, me qëllim të përfitimit të të dhënave të sakta nëse më herët kanë kryer ndonjë sulm apo marrëdhënie seksuale me fëmijë. Ekzaminimi poligrafik ka vërtetuar që rreth 55% të autorëve të krimit të pornografisë fëmijërore, më herët kanë kryer sulm seksual ndaj fëmijës.<sup>45</sup>

Nga ky studim mund të konkludohet që, dy veprat penale e lartpërmendura janë në raport të ngushtë mes vete dhe që shikuesit apo poseduesit e pornografisë fëmijërore, mund të jenë edhe kryerës potencial të sulmit seksual ndaj fëmijës.

## **6. Viktimat e pornografisë fëmijërore**

### **6.1. Moshë e fëmijëve**

Sipas normave pozitive të së drejtës penale dhe civile, si dhe në bazë të akteve ndërkombëtare, me nocionin fëmijë nënkuptohet personat nën moshën 18 vjeç. Kështu, edhe sipas Konventës për të drejtat e fëmijës, „me fëmijë nënkuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur ligjet nacionale parashohin një moshë më të hershme madhore”.<sup>46</sup>

---

<sup>45</sup> Ph.D.Michael Seto, Internet-Facilitated Sexual Offending , U.S. Department of Justice, 2015. <https://smart.ojp.gov/somapi/chapter-4-internet-facilitated-sexual-offending#introduction> (qasja e fundit më 23.07.2021)

<sup>46</sup> Convention on the Rights of the Child 44/25, 1989, neni 1.

Kur bëhet fjalë për aktet seksuale me fëmijë, të gjitha legjislacionet penale parashohin dispozita të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve. Kështu, është me rëndësi të përmendet edhe mosha e pjekurisë seksuale të fëmijëve që nënkupton, moshën nën të cilën në përputhje me ligjin nacional, ndalohet përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, e cila fitohet në një moshë më të hershme se 18.

Një nga problemet që paraqiten në fushën e pornografisë fëmijërore është se, në disa shtete mund të merret për bazë mosha e pjekurisë seksuale ndërsa në disa shtete mosha madhore e viktimës. Për shembull mosha e pjekurisë seksuale në SHBA varion nga 16 deri në 18 vjeç.<sup>47</sup> Mirëpo, sipas ligjit federal të SHBA'së 18 U.S.C. §§ 2256, me pornografinë fëmijërore nënkuptohet të gjithë personat nën moshën 18 vjet. Gjithashtu në Japoni mosha e pjekurisë seksuale merret mosha 13 vjet.<sup>48</sup> Megjithatë, në bazë të „Aktit për Ndëshkimin e Veprimtarive në lidhje me Prostitucionin e Fëmijëve, Pornografinë Fëmijërore dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (Akti Nr. 52, 1999)”, nocioni fëmijë nënkupton të gjithë personat nën 18 vjet.<sup>49</sup> Si që shihet në SHBA dhe në Japoni, kur bëhet fjalë për pornografinë fëmijërore nuk merret për bazë mosha e pjekurisë seksuale, por të gjithë fëmijët deri 18 vjet.

Sa i përket abuzimit seksual të fëmijëve në shtetin tonë, në nenin 188 të KPM, është definuar, „Sulm seksual ndaj fëmijës që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç”. Sipas këtij neni „ai i cili do të kryejë marrëdhënie apo veprim tjetër seksual me fëmijën, që nuk ka mbushur 14 vjet do të dënohet më së paku me 12 vjet burgim”. Si që vërehet te kjo vepër penale, pragu i moshës është përcaktuar mosha 14 vjeçare, që nënkupton se, sipas legjislacionit tonë ndalohet çdo aktivitet seksual me fëmijë nën moshën 14 vjeçare, për arsye se fëmijët nën moshën 14 vjeçare duhet të mbrohen nga të gjithë format e keqpërdorimeve seksuale (pedofilisë) me qëllim që të mbrohet zhvillimi i drejtë i tyre, nga ndikimet jo formale për formimin e tyre si

---

<sup>47</sup> Brandon Barnett, What is the Age of Consent in the United States?, 2016, <https://www.bhwlawfirm.com/legal-age-consent-united-states-map/> (qasja e fundit më 28.07.2021).

<sup>48</sup> Age of Consent in Japan, 2021, <https://www.ageofconsent.net/world/japan> (qasja e fundit më 28.07.2021).

<sup>49</sup> Act on Punishment of Activities Relating to Child Prostitution and Child Pornography, and the Protection of Children (Act No.52 of May 26, 1999), neni 2.

persona të shëndoshë. Në të drejtën tonë penale ndalohet çdo lloj aktiviteti seksual me fëmijën nën moshën 14 vjet, qoftë me vetdëshirë apo me forcë.<sup>50</sup>

Pra, pjekuria seksuale në vendin tonë është mosha 14 vjeçare. Mirëpo, edhe në shtetin tonë për veprën penale të pornografisë fëmijërore nuk merret për bazë mosha e pjekurisë seksuale e cila është mosha 14 vjet, por si viktimat të pornografisë fëmijërore konsiderohen të gjithë personat deri moshën 18 vjet.

Kështu, duke i marrë parasysh këto diferenca, në këtë punim me viktimitë të pornografisë fëmijërore nënkuptohet të gjithë personat nën moshën 18 vjet. Pra, me pornografinë fëmijërore nënkuptohet përfshirja e një të mituri nën moshën 18 vjet në çfarë do lloj imazhi seksual ose të turpshëm.

## **6.2. Efektet e dëmshme tek viktimat**

Viktimizimi përmes pornografisë kibernetike fëmijërore, do të thotë viktimizim që nuk mbaron kurrë.<sup>51</sup> Kjo ndodh për arsye se, imazhet e vendosura në internet, nuk mund të fshihen ose të zhduken kurrë plotësisht.

Një fëmijë që është përfshirë në imazhe pornografike, duhet ta kalojë jetën duke e ditur se ato imazhe po qarkullojnë në internetit. Thjesht mendimi se imazhet ekzistojnë dhe po qarkullojnë në internet shkakton turp, poshtërim dhe pasoja të thella emocionale tek viktimat. Ky viktimizim zgjat përgjithmonë pasi fotografitë nuk mund të fshihen kurrë plotësisht dhe mund të rishfaqen në çdo kohë.

Për shkak se fëmijët abuzohen seksualisht në krijimin e imazheve pornografike, ata mund të pësojnë lëndime fizike, dhimbje, prerje, çarje dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme.

---

<sup>50</sup> Ratkoceri Vedije, Kastrimi kimik si sanksion penal, SEEU, 2008, fq.15.

<sup>51</sup> Foothills Child Advocacy Center, The Impact of Child Pornography on Victims, <https://www.foothillscac.org/> (qasja e fundit më 28.07.2021).

Fëmijët pësojnë edhe lëndime psikologjike duke përfshirë depresionin, zemërimin, tërheqjen në vetvete dhe izolimi, ndjenja e turpit, padenjesisë dhe zemërimit, traumat, streset psikike dhe ankthet. Këto ndjenja më vonë mund të shkaktojnë akte të vetëdëmtimit, përfshirë vetëgjymtimin dhe vetëvrasjen si dhe abuzimin me substanca të ndryshme.<sup>52</sup>

## 7. Të dhëna statistikore për pornografinë fëmijërore

Pornografia fëmijërore është prezente kudo në botë. Raportuesja Speciale e OKB -së për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë fëmijërore Najat Maalla M'jid, në një raport në seancën e fundit të Këshillit për të Drejtat e Njeriut thotë se, "Pornografia fëmijërore në internet është shndërruar në një biznes shumë fitimprurës me vlerë në miliarda dollarë në vjet". Në bazë të të dhënave statistikore zyrtare, është vlerësuar se në çdo kohë ka rreth 750,000 predatorë seksual që kërkojnë faqe në internet që shfaqin pornografi me fëmijë.<sup>53</sup>

Statistikat për pornografinë kibernetike fëmijërore janë të vështira për t'u gjetur, por në raportin e saj M'jid potencon se gjatë një periudhe trevjeçare midis 2001 dhe 2004 numri i faqeve që përmbajnë pornografi me fëmijë është dyfishuar në 480,000. Të dhënat për numrin e viktimave ndryshojnë, nga 10.000 në 100,000. Në këtë raport gjithashtu është vlerësuar edhe moshën e viktimave, ku rreth 20% i personave që posedonin pornografi me fëmijë kanë patur imazhe të foshnjave nën moshën 3 vjeç, dhe më shumë se 80% kanë patur imazhe të fëmijëve midis moshës 6 dhe 12 vjeç.<sup>54</sup>

---

<sup>52</sup> Rogers Audrey, Child Pornography's Forgotten Victims, 28 Pace L. Rev. 847 (2008), Fq.853 <http://digitalcommons.pace.edu/lawfaculty/541/>

<sup>53</sup> United Nations Human Rights Office of the High Commissioner, Child pornography flourishes in a world with no borders, 2009, <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/ChildPornography.aspx> (qasja e fundit më 01.08.2021)

<sup>54</sup> Najat M'jid Maalla, Report of the Special Rapporteur on the sale of children, child prostitution and child pornography, 2009, GE.09-14627 (E) 010909 040909, fq.9.



## 7.1. Pornografia fëmijërore në rrjete sociale

Më lartë, tek format e manifestimit të pornografisë fëmijërore, u përmend që pornografitë me fëmijë nuk janë të arritshme në zona të hapura të internetit, por ekzistojnë platforma posaçërisht të krijuara për ngarkimin e imazheve pornografike si, tabelat e njoftimit, grupe të lajmeve, dhoma të bisedave, rrjeteve kompjuterike (P2P) etj.. Mirëpo jo çdo kush mund të arrijë që të kyqet në këto platforma. Andaj shumica e predatorëve i përdorin rrjetet sociale për ti përmbushur kërkesat e tyre.

Sipas raporteve të transparencës së rrjeteve sociale, çdo vit fshihen me miliona postime dhe imazhe që bien ndesh me ligjin në lidhje me nuditetin, shfrytëzimin dhe abuzimin e fëmijëve, në Facebook, Instagram, Youtube, Twitter, TikTok, Reddit dhe Snapchat. Në vazhdim është paraqitur tabela nr.1, me të dhënat statistikore sipas raportit të transparencës së rrjeteve sociale për vitin 2018, 2019 dhe 2020 sa i përket numrit të llogarive dhe postimeve të fshira varësisht rrjetit social.<sup>55</sup>

| Tabela nr.1 | Numri i llogarive dhe postimeve të fshira me përmbajtje pornografike fëmijërore |            |            |
|-------------|---|------------|------------|
| Platforma   | 2018  | 2019       | 2020       |
| Facebook    | 16.200,000  | 37.400,000 | 35.900,000 |
| Instagram   | 0   | 1.972,000  | 3.280,000  |
| Youtube     | 1.115,281   | 3.347,488  | 11,623,930 |
| Twitter     | 460,008   | 525,004    | 455,124    |
| TikTok      | Nuk ka të dhëna   | 12.213,427 | 23.313,249 |
| Reddit      | 10,537  | 38,410     | 45,595     |
| Snapchat    | Nuk ka të dhëna   | 50,616     | 50,616     |

<sup>55</sup> Paul Bischoff, The rising tide of child abuse content on social media, 2021, <https://www.comparitech.com/blog/vpn-privacy/child-abuse-online-statistics/> (qasja e fundit më 05.08.2021)


Si që vërehet nga tabela, vetëm në Facebook në vitin 2018 janë fshirë 16,2 milion postime dhe llogari me përmbajtje pornografike fëmijërore, ndërsa në vitin 2019 dhe 2020 numri i postimeve dhe llogarive të fshira është dyfishuar në 37.4 milion dhe 35.9 milion. Në Instagram në vitin 2018 nuk është fshirë asnjë postim, ndërsa në vitin 2019 janë fshirë 1.972,000 postime dhe llogari, ndërsa në vitin 2020 numri i përmbajtjeve të hequra është 3.280,000. Edhe në Youtube vërehet rritja e numrit të postimeve të fshira, prej vitit 2018 me 1.115,281, në vitin 2019 3.347,488, dhe në vitin 2020 11,623,930 postime. Ndryshe nga Facebook, Instagram dhe Youtube, në Twitter numri i postimeve dhe llogarive të fshira është me i ulët, ku për vitin 2018 janë fshirë 460,008 postime, në vitin 2019 525,004 postime, në vitin 2020 455,124 postime. Për TikTok për vitin 2018 nuk ka të dhëna sa i përket numrit të llogarive dhe postimeve të fshira, ndërsa për vitin 2019 me 12.213,427 postime të fshira në vitin 2020 ky numër gati është dyfishuar në 23.313,249. Në Reddit dhe Snapchat vërehet numri i ulët i postimeve dhe llogarive të fshira. Në vitin 2018 në Reddit janë fshirë 10,537 postime, 38,410 në 2019 dhe 45,595 në 2020. Për Snapchat për vitin 2018 nuk ka të dhëna, ndërsa për 2019 dhe 2020 numri postimeve dhe llogarive të fshira është i njëjt 50,616.

Ajo që na e tërhek vërejtjen në këtë tabelë, është rritja e numrit të postimeve dhe llogarive të fshira për vitin 2020, në krahasim me dy vitet e mëparshme. Si faktorë e kësaj rritjeje, padyshim është periudha e pandemisë së Covid-19. Për të parandaluar përhapjen e Covid-19, qeveritë vendosën kufizime të menjëhershme në jetën shoqërore, si mbyllja e shkollave pra mësimi nga distanca, mbyllja e vendeve të punës-puna nga distanca, mbyllja e vendeve të argëtimit, vendosja kufizimeve të lëvizjes si ora policore etj.. Këto kufizime kanë sjellë ndryshime të papritura në jetën e përditshme të njerëzve. Kështu si pasojë e kufizimit të lëvizjes dhe me kalimin e kohës në shtëpi është rritur edhe përdorimi i mjeteve digjitale dhe internetit. Ashtu si fëmijët, por edhe të rriturit kanë patur më shumë kohë të lirë gjatë qëndrimit në karantinë, dhe këtë kohë e kanë kaluar duke shikuar dhe shkarkuar pornografi me fëmijë nëpër rrjete sociale.

## 7.2. Profili i viktimave

Në trajtimet mbi fëmijët viktima, është me rëndësi të analizohet edhe profili i tyre, duke i marrë parasysh grupmoshat e viktimave, gjininë e viktimave si dhe raportin e viktimës me viktimizuesin e saj.


Për pasqyrën statistikore të profilit të viktimave jemi referuar të dhënave nga Qendra Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar (NCMEC), e cila që nga viti 2002 ka filluar mbledhjen e imazheve të abuzimit të fëmijëve, përmes Programit të saj për Identifikimin e Fëmijëve Viktima të Pornografisë Fëmijërore (CVIP -Child Victim Identification Program). Që nga fillimi i programit në 2002, CVIP ka dedektuar më shumë se 330 milion fotografi dhe video me pornografi fëmijërore. Në vazhdim janë paraqitur diagramet nga CVIP sa i përket grupmoshave, gjinisë dhe raportit të fëmijëve viktima me viktimizuesit e tyre.<sup>56</sup>



Në këtë diagram janë paraqitur grupmoshat e fëmijëve si viktima të pornografisë fëmijërore. Si që shihet numri më mi lartë i fëmijëve viktima me 60% nga numri i përgjithshëm,


<sup>56</sup> National Center for Missing and Exploited Children, <https://www.missingkids.org/content/ncmec/en/ourwork/impact.html> (qasja e fundit më 10.08.2021)

janë fëmijët para pubertetit, ndërsa 32% janë fëmijë në pubertet. Është shqetësues fakti që si viktima të këtij krimi janë edhe foshnjët me 9% nga numri i përgjithshëm.



Siç po shihet, sipas këtij diagrami numri më i lartë i viktimave paraqiten vajzat me 64%, dhe djemtë me 36%.

## Raporti i fëmijëve viktimë me viktimizuesit e tyre



Nga të dhënat e paraqitura në diagramin e mësipërm, del se numri më i lartë i abuzuesve të fëmijëve janë nga rrethi familjar i tyre. Numri më i lartë i kryerësve të pornografisë fëmijërore paraqiten vetë prindërit e fëmijëve, pastaj rrethi miqësor, komshinjtë apo miqtë familjar, anëtarët e familjes, kujdestari ose partneri i kujdestarit. Pra, gjithsej 67% i viktimizuesve janë nga rrethi familjar i fëmijëve gjegjësisht nga persona të njohur më parë. Ndërsa, si viktimizues të huaj paraqiten persona të panjohur për fëmijën, joshësit online dhe trafikantët seksual fëmijësh gjithsej 23%, dhe 10% i pornografisë fëmijërore rezulton si vetëprodhim nga ana e fëmijëve.

## KAPITULLI I TRETË

### Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia fëmijërore

#### 1. Konventa për krimin kibernetik

Konventa për Krimin Kibernetik e miratuar nga Këshillit i Evropës në vitin 2001 (CETS Nr.185), e njohur si Konventa e Budapestit, është instrumenti i parë ndërkombëtar mbi krimet e kryera përmes internetit dhe rrjeteve të tjera kompjuterike, që kanë të bëjnë veçanërisht me shkeljet e të drejtave të autorit, mashtrimet e lidhura me kompjuterin, pornografinë fëmijërore dhe shkeljet e sigurisë së rrjetit. Objektivi kryesor i kësaj konvente, është të ndjekë një politikë të përbashkët kriminale që synon mbrojtjen e shoqërisë nga krimi kibernetik, veçanërisht duke miratuar legjislacionin e duhur dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar.<sup>57</sup>

Pornografia fëmijërore në këtë konventë është inkriminuar në nenin 9, duke kërkuar forcimin e masave mbrojtëse për fëmijët, përfshirë mbrojtjen e tyre kundër shfrytëzimit seksual, gjegjësisht të ndalohet në mënyrë efektive përdorimi i sistemeve kompjuterike në kryerjen e veprave seksuale kundër fëmijëve.

Neni 9 i kësaj konvente detyron që „çdo palë të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë, në drejtimit e mëposhtme:

- a) prodhimin e pornografisë fëmijërore, me qëllimin e shpërndarjes së tij nëpërmjet një sistemi kompjuterik;
- b) ofrimi apo vënia në disponim pornografinë fëmijërore përmes një sistemi kompjuterik;
- c) shpërndarja apo transmetimi i pornografisë fëmijërore përmes një sistemi kompjuterik;
- d) prokurimi i pornografisë fëmijërore përmes një sistemi kompjuterik për vete apo tjetrin;

---

<sup>57</sup> Convention on Cybercrime (CETS No.185), Budapest, 2001.

e) zotërimi i pornografisë fëmijërore përmes një sistemi kompjuterik apo në një mjet të memorizimit të të dhënave kompjuterike”.<sup>58</sup>

Po ashtu në këtë dispozitë specifikohet se çfarë përfshin materiali pornografik me fëmijë që dallon nga ana pamore:

a) një i mitur, i cili angazhohet në akte të qarta seksuale;

b) një person, i cili duket që është i mitur, i angazhuar në akte të qarta seksuale;

c) imazhe realiste që prezantojnë një i mitur të angazhuar në akte të qarta seksuale.

Me „akte të qarta seksuale” nënkuptohen të gjithë aktivitetet seksuale, si: marrëdhëniet seksuale, duke përfshirë ato gjenital-gjenital, oral-gjenital, anal-gjenital ose oral-anal, ndërmjet të miturve, ose ndërmjet një të rrituri dhe një të mituri, të të njëjtës gjini ose të kundërt; bestializmin; masturbimin; abuzimin sadist ose mazohist; si dhe shfaqja e organeve gjenitale ose publike të fëmijëve, në mënyrë që të ngacmojë epshin seksual të shikuesit.<sup>59</sup>

Sa i përket llojeve të pornografisë, në dispozitën e lartë përmendur janë përmendur 3 lloje të pornografisë fëmijërore. Lloji i parë ka të bëjë me pornografinë kur paraqitet një fëmijë i vërtetë në akte të qarta seksuale, lloji i dytë ka të bëjë me imazhet pornografike të cilat paraqesin një person i moshës madhore por që duket si i mitur i përfshirë në akte eksplicite seksuale, si dhe lloji i tretë ka të bëjë me „imazhe realiste”, që nënkupton pornografinë morphing me fëmijë apo pornografi të krijuar tërësisht nga kompjuteri.<sup>60</sup>

Në lidhje me këtë dispozitë, me termin „i mitur” nënkuptohet, të gjithë personat nën moshën 18 vjet. Mirëpo, shtetet pale kanë të drejtë të kërkojnë një limit moshe më të vogël, e cila nuk duhet të jetë më pak se 16 vjet.<sup>61</sup>

Si që shihet, kjo dispozitë inkriminon vepra të ndryshme sa i përket pornografisë fëmijërore, siç janë: prodhimi, shpërndarja elektronike, posedimi apo zotërimi, ofrimi dhe

---

<sup>58</sup> Convention on Cybercrime (CETS No.185), Budapest, 2001, neni 9.

<sup>59</sup> Explanatory Report to the Convention on Cybercrime Budapest, 2001, pika 100.

<sup>60</sup> Po aty, pika 101.

<sup>61</sup> Convention on Cybercrime (CETS No.185), Budapest, 2001, neni 9. <https://rm.coe.int/1680081561>

prokurimi i pornografisë fëmijërore. Edhe pse shumica e shteteve tashmë e kriminalizojnë prodhimin tradicional dhe shpërndarjen në hard-copy të pornografisë fëmijërore, por me përdorimin gjithnjë e më shumë të internetit si mjet kryesor për shpërndarjen e materialeve të tilla, ka patur nevojë që të kriminalizohet edhe kjo formë të re e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve me qëllim të parandalimit.

## **2. Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual**

Konventa e Këshillit të Evropës për „Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”, e njohur gjithashtu si Konventa e Lanzarote’s (2007), konsiderohet si akti më i rëndësishëm ndërkombëtar sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve.<sup>62</sup>

Kjo konventë është miratuar për qëllim që të parandalojë dhe të luftojë abuzimin seksual të fëmijëve; të mbrojë të drejtat e fëmijëve viktima të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual; të nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve<sup>63</sup>. Me nocionin „Fëmijë” në këtë konventë konsiderohet çdo person nën moshën 18 vjeç.<sup>64</sup>

Sipas kësaj konvente, veprat penale që kanë të bëjnë me „shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve” konsiderohen: përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, prostituimi i fëmijëve, pornografia fëmijërore, pjesëmarrja e një fëmije në performanca pornografike, korruptimi i fëmijëve si dhe joshja fëmijëve për qëllime seksuale.<sup>65</sup>

Pornografia fëmijërore sipas kësaj konvente nënkupton „çdo lloj materiali që përshkruan në mënyrë vizuale një fëmijë të përfshirë në një sjellje reale ose seksualisht të simuluar ose çdo

---

<sup>62</sup> Council of Europe Convention on the Protection of Children against Sexual Exploitation and Sexual Abuse CETS 201, Lanzarote, 2007. <https://rm.coe.int/1680084822>

<sup>63</sup> Po aty, neni 1.

<sup>64</sup> Po aty, neni 3.

<sup>65</sup> Po aty, neni 18-23.



pasqyrim (përshkrim) të organeve seksuale të fëmijës për qëllime kryesisht seksuale”.<sup>66</sup> Si forma të kryerjes të pornografisë fëmijërore, sipas kësaj konvente konsiderohet prodhimi, ofrimi ose vënia në dispozicion, shpërndarja ose transmetimi, prokurimi për vete ose për një person tjetër, posedimi si dhe aksesit nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimeve tek pornografia fëmijërore.<sup>67</sup>

Si vepra penale që kanë të bëjnë me „pjesëmarrjen e një fëmije në performanca pornografike”, sipas nenit 21 të konventës konsiderohet: rekrutimi fëmijëve për të marrë pjesë në performanca pornografike ose shkaktimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në performanca të tilla; detyrimi i një fëmije për pjesëmarrje në performanca pornografike, ose shfrytëzimi i fëmijëve për qëllime të tilla; pjesëmarrja me vetëdije në performanca pornografike të cilat përfshijnë fëmijë.<sup>68</sup>

Në nenin 2 është përcaktuar parimi i mosdiskriminimit dhe dispozitat e kësaj konvente duhet aplikuar pa marrë parasysh racën, gjininë, ngjyrën e lëkurës, gjuhën, fenë, nacionalitetin, botëkuptimet politike dhe botëkuptimet e tjera, përkatësinë kulturore, gjendjen e ekonomike, origjinën etnike apo sociale, gjendjen shëndetësore si dhe të metat psikike apo fizike.

### **3. Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë fëmijërore**

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara 44/25 ,më 20 nëntor të vitit 1989, konsiderohet si një nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në të gjitha fushat e jetës.<sup>69</sup>

---

<sup>66</sup> Po aty, neni 20.

<sup>67</sup> Po aty, neni 20.

<sup>68</sup> Po aty, neni 21.

<sup>69</sup> Convention on the Rights of the Child 44/25, 1989.

<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

Mirëpo, për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual, në këtë konventë nuk ka ndonjë përkufizim specifik, megjithatë në nenin 34, urdhërohet që shtetet palë duhet të marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme të shfrytëzimit dhe keqtrajtimit seksual dhe të marrin të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar: fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale; fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni dhe fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Për arsye se Konventa mbi të drejtat e fëmijëve nuk përmban ndonjë dispozitë specifike që i referohet shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, më 25 maj të vitit 2000, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e ka miratuar „Protokolin Opsional mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë fëmijërore”.<sup>70</sup>

Në këtë protokol identifikohet kuptimi i akteve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin dhe abuzimit seksual të fëmijëve, gjegjësisht veprimtaria e shitjes, prostitucionit dhe pornografisë fëmijërore. Ky protokoll në nenin 1, kërkon nga shtetet palë që të ndalojnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë.

Pornografia fëmijërore, sipas këtij protokoli nënkupton „*çdo formë paraqitjeje, me çfarëdo mjeti, i një fëmije të përfshirë në aktivitete të qarta seksuale, reale ose të simuluar, ose çdo demonstrim i pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale*”.<sup>71</sup> Më pas në nenin 3, përcaktohen se cilat veprimtari duhet të jenë penalizuese sa i përket pornografisë fëmijërore, si prodhimi, shpërndarja, importimi, eksportimi, ofrimi, shitja ose mbajtja e pornografisë me fëmijë.

Ky protokol në nenin 10, gjithashtu kërkon nga shtetet palë që të marrin të gjitha hapat e duhur për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar shumëpalësh, rajonal ose dypalësh për parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e personave përgjegjës për veprime që përfshijnë shitjen, prostitucionin, pornografinë dhe turizmin seksual me fëmijë; për të ndihmuar fëmijët viktime në shërimin e tyre fizik dhe psikologjik, riintegrimin shoqëror dhe

---

<sup>70</sup> Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the sale of children, child prostitution and child pornography A/RES/54/263, 2000. <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opsccrc.aspx>

<sup>71</sup> Po aty, neni 2.

riatdhesimin; të hulumtohen shkaqet bazë të cilat ndikojnë në ekspozimin e fëmijëve kundrejt shitjes, prostitucionit dhe pornografisë me fëmijë, siç është varfëria dhe prapambetja.

#### **4. Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit „Për luftën ndaj abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografinë fëmijërore”**

Një ndër instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia fëmijërore është edhe „Direktiva 2011/93/ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit „Për luftën ndaj abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografinë fëmijërore”, e miratuar më 13 dhjetor të vitit 2011.<sup>72</sup>

Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve, përfshirë pornografinë fëmijërore, përbëjnë shkelje serioze të të drejtave themelore të fëmijëve, veçanërisht pornografia fëmijërore, e cila po rritet dhe përhapet dita e ditës përmes përdorimit të teknologjive të reja dhe internetit.

Me qëllim të parandalimit të këtyre krimeve dhe mbrojtjes së të drejtave esenciale të fëmijëve, Parlamenti Evropian e ka miratuar direktivën e sipërcituar, në të cilën janë përcaktuar rregullat minimale në lidhje me përkufizimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, pornografisë fëmijërore dhe joshjen e fëmijëve për qëllime seksuale. Gjithashtu, direktiva përmban dispozita për parandalimin e këtyre krimeve dhe mbrojtjen e viktimave.

Ashtu si edhe në aktet tjera ndërkombëtare, edhe me këtë direktivë, me „fëmijë” nënkuptohet çdo person nën moshën 18 vjeç, ndërsa „mosha e arritjes së pjekurisë seksuale”(age of sexual consent), nënkupton moshën nën të cilën, në përputhje me ligjin kombëtar, është e ndaluar përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë.<sup>73</sup>

---

<sup>72</sup> Directive 2011/93/EU of the European Parliament and of the Council of 13 December 2011 on combating the sexual abuse and sexual exploitation of children and child pornography <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32011L0093>

<sup>73</sup> Po aty, neni 2, paragrafi (a) dhe (b).

„*Pornografi fëmijërore*, sipas kësaj direktive nënkupton:

(a) çdo material që përshkruan vizualisht një fëmijë të përfshirë në akte seksuale reale ose të simuluar;

(b) çdo përshkrim i organeve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale;

(c) çdo material që përshkruan vizualisht një person që duket se është një fëmijë i përfshirë në akte seksuale reale ose të simuluar ose ndonjë përshkrim të organeve seksuale të çdo personi që duket se është fëmijë, për qëllime kryesisht seksuale; ose

(ç) imazhe realiste të një fëmije të përfshirë në akte eksplicite seksuale ose imazhe realiste të organeve seksuale të një fëmije, për qëllime kryesisht seksuale”.<sup>74</sup>

Me „*Performancë pornografike* nënkuptohet, ekspozimi i drejtpërdrejtë të një fëmije i përfshirë në aktet reale ose të simuluar eksplicite seksuale ose shfaqja e organeve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale, që i drejtohet auditorit me anë të teknologjisë së informatikës dhe komunikimit”.<sup>75</sup>

Sa i përket mënyrave të kryerjes së pornografisë fëmijërore, në nenin 5 të direktivës, parashihet detyrimi i shteteve anëtare të Bashkimit Europian për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që veprime të tilla të qëllimshme për blerjen, posedimin, aksesin apo qasjen me vetëdije me anë të teknologjisë së informatikës dhe komunikimit, shpërndarjen dhe transmetimin, ofrimin, furnizimin apo vendosjen në dispozicion të materialeve më përmbajtje pornografike si dhe prodhimin e pornografisë fëmijërore, të përcaktohen si vepër penale në legjislacionet penale kombëtare.

Nuk ka dyshim që në këtë epokë digjitale, janë krijuar forma të ndryshme të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, të cilat lehtësohen nga përdorimi i teknologjisë së informatikës dhe komunikimit, siç është joshja e fëmijëve për qëllime seksuale përmes rrjeteve sociale dhe dhomave të bisedave në internet. Andaj kjo direktivë, në nenin 6, i detyron shtetet anëtare që

---

<sup>74</sup> Po aty, neni 2, paragrafi (c).

<sup>75</sup> Po aty, neni 2, paragrafi (e).

të parashohin si vepër penale edhe joshjen e fëmijëve për qëllime seksuale. Gjegjesisht, shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme që të dënohet, „propozimi” me anë të teknologjisë së informatikës dhe komunikimit, nga ana e një të rrituri për të takuar një fëmijë që nuk ka mbushur moshën e pjekurisë seksuale, me qëllim të kryerjes së ndonjë prej veprave penale në lidhje me abuzimin seksual(në nenin3.paragrafi4,) dhe pornografinë fëmijërore (në nenin 5, paragrafi 6).

Sa i përket web-faqeve që përmbajnë pornografi fëmijërore, i referohemi nenit 25, ku sipas këtij neni, shtetet anëtare detyrohen të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar heqjen e menjëhershme të faqeve të internetit që përmbajnë ose përhapin pornografi me fëmijë, brenda territorit të tyre dhe të përpiqen të sigurojnë heqjen e faqeve të tilla edhe jashtë territorit të tyre. Shtetet anëtare, gjithashtu detyrohen të marrin masa për të bllokuar hyrjen në faqet e internetit që përmbajnë ose shpërndajnë pornografi me fëmijë drejt përdoruesve të internetit brenda territorit të tyre.

## KAPITULLI I KATËRT

### Vështrime krahasuese të pornografisë fëmijërore

#### 1. Rishikimi legjislativ global

Në këtë pjesë të punimit, është bërë një analizë të legjislacionit të të gjitha shteteve në botë sa i përket kontributit të tyre për mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia. Të dhënat që janë të paraqitura më poshtë janë marrë nga Qendra Ndërkombëtare e Fëmijëve të Humbur dhe Shfrytëzuar.

Qendra Ndërkombëtare e Fëmijëve të Humbur dhe Shfrytëzuar (ICMEC), e formuar në vitin 1998, me seli në Aleksandria Virxhinia, është një organizatë globale joqeveritare dhe jo fitimprurëse, e cila është formuar me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi seksual, pornografia me fëmijë dhe rrëmbimi i fëmijëve. Kjo organizatë krijon raporte, duke analizuar legjislacionet e 196 shteteve në botë, sa i përket angazhimit të tyre për mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia fëmijërore. Prej formimit të organizatës deri më sot, gjithsej janë publikuar 9 raporte, i pari në vitin 2006 ndërsa raporti i fundit në vitin 2018. Në vazhdim do të analizohet raporti i fundit të ICMEC, i cili është publikuar në vitin 2018.<sup>76</sup>

Për të dhënë një pasqyrim më të qartë rreth legjislacionit të shteteve sa i përket pornografisë fëmijërore, ky raport<sup>77</sup> është i bazuar në 5 kritere, nëse legjislacioni kombëtar:

- 1) e inkriminon pornografinë fëmijërore;
- 2) e përkufizon pornografinë fëmijërore;


---

<sup>76</sup> Në këtë raport (botimi i 9 –të), ICMEC e ka zëvendësuar termin "pornografi fëmijërore" me termin "material me abuzim seksual të fëmijëve" për t'u përshtatur me terminologjinë e pranuar tani nga komuniteti ndërkombëtar i mbrojtjes së fëmijëve. Gjithsesi, në të gjitha botimet e mëparshme të ICMEC është përdorur termi „pornografia fëmijërore”, i cili është i pranuar edhe ndërkombëtarisht andaj edhe në këtë punim është përdorur i njëjti.

<sup>77</sup> International Centre for Missing & Exploited Children (ICMEC), Child Sexual Abuse Material: Model Legislation & Global Review, 9th Edition, 2018. <https://www.icmec.org/child-pornography-model-legislation-report/> (qasja e fundit më 03.09.2021).

- 3) e inkriminon pornografinë fëmijërore të kryer me anë të teknologjisë së informatikës;
- 4) e inkriminon posedimin e pornografisë fëmijërore, pavarësisht nga qëllimi për të shpërndarë;
- 5) kërkon nga Ofruesit e Shërbimeve të Internetit (ISP) që të raportojnë pornografi të dyshuar me fëmijë, tek zbatuesit e ligjit (law enforcement) ose tek ndonjë agjenci tjetër e autorizuar.

Në vijim janë paraqitur të dhënat nga raporti i 9-të të ICMEC, sa i përket kontributit të të gjithë shteteve në botë për mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia fëmijërore. Raporti është bazuar në 5 kritere të lartpërmendura, dhe janë analizuar se sa shtete i përmbushin ato kritere dhe sa shtete jo.



**21** shtete i plotësojnë 5 kritere.

**97** shtete i plotësojnë 4 kritere.

**62** shtete i plotësojnë 1-3 kritere.


**16** shtete nuk plotësojnë asnjë kriter.

Nga të dhënat e paraqitura vërehet se vetëm 11% të shteteve në botë, i plotësojnë 5 kriteret që sipas ICMEC janë të domosdoshme që ti përmbush çdo shtet për parandalimin e pornografisë fëmijërore. 21 shtete që i plotësojnë të gjitha kriteret janë: Australia, Bahamet, Butani, Belgjika, Kanada, Kolombia, Bregu i Fildishtë, Franca, Guinea, Guajana, India, Italia,

Malavi, Nauru, Nigeria, Filipinet, Afrika e Jugut, Svazilandi, Uganda, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sipas ICMEC shtetet që i plotësojnë 4 kriteret konsiderohen si shtete me legjislacion të mjaftueshëm për të luftuar pornografinë fëmijërore. Të tilla janë 97 shtete që i plotësojnë 4 kriteret, me një përqindje prej 49%. Nga të dhënat vërehet se 32% i shteteve, gjegjësisht 62 shtete i plotësojnë vetëm 3 kriteret.

Është shqetësues fakti se 8% i shteteve, gjithsej 16 shtete nuk plotësojnë asnjërin nga kriteret e ICMEC. Kjo nënkupton se vepra penale e pornografisë fëmijërore nuk është inkriminuar si vepër penale në legjislacionet e tyre. Shtetet që nuk e përcaktojnë pornografinë fëmijërore si vepër penale janë: Afganistani, Guinea Ekuatoriale, Guinea Bissau, Irani, iraku, Kuvajti, Libani, Libia, Mikronesia, Nepal, Korea e Veriut, Somalia, Siria, Tunizia, Tuvalu dhe Jemeni.




Në këtë grafikon është paraqitur se sa shtete e plotësojnë kriterin e dytë të ICMEC, sa i përket përkufizimit të pornografisë fëmijërore. Edhe pse numri i konsiderueshëm i shteteve e kanë inkriminuar si vepër penale pornografinë fëmijërore, prapë se prapë 71 shtete nuk e kanë definuar se çfarë nënkuptohet me pornografinë fëmijërore.



## Pornografia fëmijërore e kryer me anë të teknologjisë së informatikës


■ 155 shtete e plotësojnë ■ 41 shtete nuk e plotësojnë



Në këtë grafikon janë paraqitur të dhënat për kriterin e tretë të ICMEC, se sa shtete e përcaktojnë si vepër penale pornografinë fëmijërore të kryer me anë të teknologjisë së informatikës. Vërehet që edhe pse 79%, gjithsej 155 shtete plotësojnë këtë kriteri, ndërsa 21%, gjithsej 41 shtete nuk e plotësojnë. Shtetet që nuk e plotësojnë këtë kriter janë: Azerbajxhani, Burundi, Republika e Afrikës Qëndrore, Komoret, Kuba, Guinea Ekuatoriale, Eritrea, Guinea Bisau, Haiti, Irani, Iraku, Kazakistani, Kirgistani, Kuvajti, Lebanoni, Lesotho, Libja, Lituania, Maldivet, Mali, Ishujt Marshall, Mauritiusi, Mikronezia, Namibia, Nepali, Nigeri, Korea e Veriut, Ishujt Solomon, Somalia, Sudani, Sudani i Jugut, Sri Lanka, Siria, Taxhikistani, Tunisia, Turqia, Turkmenistani, Tuvalu, Uzbekistani, Vietnami, Jemeni dhe Zimbabaveja.

## Posedimi i pornografisë fëmijërore


- 140 shtete e kanë inkriminuar posedimin e pornografisë fëmijërore.
- 56 shtete nuk e kanë inkriminuar posedimin e pornografisë fëmijërore.



Në këtë grafikon janë paraqitur se sa shtete e plotësojnë kriterin e katërt të ICMEC. Ky grafikon tregon që 71% , gjithsej 140 shtete e kanë inkriminuar posedimin e pornografisë fëmijërore pavarësisht qëllimit për të shpërndarë, ndërsa 29%, gjithsej 56 shtete nuk e kanë inkriminuar.

## Raporti nga ISP

- 32 shtete kërkojnë nga ISP -ja të raportojë për pornografi të dyshuar me fëmijë.
- 164 shtete nuk kërkojnë



Ky grafikon na tregon sa shtete e plotësojnë kriterin e pestë të ICMEC, gjegjësisht se sa shtete kërkojnë nga Ofruesit e Shërbimeve të Internetit (ISP) që të raportojnë pornografi të

dyshuar me fëmijë, tek zbatuesit e ligjit (law enforcement) ose tek ndonjë agjenci tjetër e autorizuar.

Fakti që pornografia tradicionale është transferuar në fushën e kibernetikës, është e domosdoshme që në luftën kundër pornografisë me fëmijë të angazhohen edhe Ofruesit e Shërbimeve të Internetit (ISP), duke raportuar pornografi të dyshuar me fëmijë.

Është alarmues fakti që vetëm 16%, gjithsej 32 shtete në botë kërkojnë nga Ofruesit e Shërbimeve të Internetit (ISP) që të raportojnë pornografi të dyshuar me fëmijë, ndërsa 84%, gjithsej 164 shtete nuk kërkojnë. Pornografia fëmijërore në internet nuk mund të parandalohet nëse shtetet nuk e plotësojnë këtë kriter.

Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga pornografia fëmijërore, është me rëndësi që të përmenden edhe disa sugjerime të ICMEC, të cilat duhen marrë parasysh nga ana e shteteve.<sup>78</sup> ICMEC në të gjitha raportet e saj sugjeron që, të gjitha shtetet në legjislacionet e tyre, sa i përket pornografisë fëmijërore, nocionin „fëmijë”, të përcaktojnë si çdo person i cili është nën moshën 18 vjeç pavarësisht moshës së pjekurisë seksuale. Ky sugjerim është dhënë duke u nisur nga fakti se moshë ligjore e pjekurisë seksuale të fëmijëve ndryshon në legjislacionet e shteteve të ndryshme, dhe kjo paraqet pengesë për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në nivel ndërkombëtar.

ICMEC gjithashtu sugjeron që „pornografia fëmijërore” të përkufizohet duke i përshtatur terminologjisë specifike të kompjuterit dhe internetit. Sipas ICMEC është e domosdoshme që, me ardhjen e internetit dhe teknologjisë së informatikës, të përcaktohen të gjitha format që vepra penale e pornografisë fëmijërore mund të kryhet. Kështu duhet të përkufizohen të gjitha format apo metodat me të cilat mund të kryhet kjo vepër penale, duke mos u kufizuar vetëm në pajisjet tradicionale të kompjuterit si: inçizim, DVD, CD-ROM, disketë, CD-R, skedarë, pajisje për ruajtjen e të dhënave, softuer ose media të tjera elektronike ose digjitale, por duhet të përcaktohen edhe mënyrat më të reja se si mund të prodhohet dhe të shpërndahet pornografia

---

<sup>78</sup> International Centre for Missing & Exploited Children (ICMEC), Child Sexual Abuse Material: Model Legislation & Global Review, 9th Edition, 2018, fq.7-14. I qasshëm në <https://cdn.icmec.org/wp-content/uploads/2018/12/CSAM-Model-Law-9th-Edition-FINAL-12-3-18-1.pdf> (qasja e fundit 03.09.2021).

fëmijërore përmes rrjeteve kompjuterike dhe internetit; të gjitha mënyrat në të cilat mund të posedohet pornografia fëmijërore përfshirë thjesht shikimin me vetëdije të një imazhi në internet ose shkarkimin me vetëdije të atyre imazheve.

ICMEC në raportet e saj, sugjeron përcaktimin si vepër penale edhe të posedimit të pornografisë fëmijërore pavarësisht nga qëllimi për të shpërndarë, sepse çdo imazh i pornografisë fëmijërore që merret inkurajon rritjen e mëtejshme të kësaj industrie të paligjshme dhe kontribuon në zhvillimin e tendencave të reja alarmante, të tilla si pornografia fëmijërore „me porosi“- shitja e imazheve të përdhunimit të fëmijëve të krijuara me porosi për konsumatorin dhe „real-time“ pornografia e fëmijëve, për të cilën abonentët paguajnë për të parë përdhunimin e fëmijëve të transmetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Sipas një studimi i vitit 2011 në Shtetet e Bashkuara, u zbulua se 41% e poseduesve të pornografisë fëmijërore të arrestuar ishin „kryerës të dyfishtë“, të cilët viktimizonin seksualisht fëmijët dhe posedonin pornografi me fëmijë. Sipas këtij studimi, një në çdo gjatë raste, personat që kanë poseduar pornografi fëmijërore gjithashtu kanë abuzuar seksualisht një fëmijë ose kanë tentuar ta abuzonin. Nga kjo mund të kuptojmë, që personat të cilët posedojnë pornografi me fëmijë, janë kryerës potencial për abuzimin e fëmijëve. Andaj kërkohet që të përcaktohet si vepër penale edhe posedimi i pornografisë fëmijërore me qëllim të parandalimit të rritjes së kësaj industrie, por gjithashtu të parandalohen rastet e mëtejshëm të abuzimit seksual.

ICMEC gjithashtu sugjeron të përcaktohet si vepër penale shkarkimin ose shikimin me vetëdije të imazheve të pornografisë fëmijërore në internet dhe përdorimin e internetit për të shpërndarë pornografinë fëmijërore. Të ndëshkohen edhe ato persona që bëjnë të ditur për të tjerët se ku mund të gjejnë pornografi me fëmijë, si për shembull: ofrimi i informacionit se ku mund të gjendet pornografia me fëmijë duke sugjeruar një adresë në uebfaqe. Gjithashtu duhet të ndëshkohen edhe prindërit e fëmijëve ose kujdestarët ligjor, të cilët lejojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë në materiale me përmbajtje pornografike.

## 2. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

### 2.1 Pornografia fëmijërore në Ligjin Federal

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pornografia fëmijërore konsiderohet si një formë e shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Statutet federale të pornografisë fëmijërore janë të kodifikuara në titullin 18 U.S.C. §§ 2251-2260.<sup>79</sup>

Ligji Federal e përkufizon pornografinë fëmijërore si „çdo përshkrim vizual i një të mituri përfshirë në akte eksplicite seksuale”.<sup>80</sup> Si i mitur konsiderohet çdo person nën moshën 18 vjet. Përshkrimet vizuale përfshijnë fotografitë, videot, imazhet digjitale të krijuara nga kompjuteri të cilat nuk dallojnë nga një i mitur i vërtetë, dhe imazhe të krijuara ku paraqitet një i mitur i vërtetë. Imazhet e pornografisë fëmijërore gjithashtu quhen imazhe të abuzimit seksual të fëmijëve.<sup>81</sup>

Ligji Federal ndalon prodhimin, shpërndarjen, importimin, marrjen ose posedimin e çdo imazhi të pornografisë me fëmijë.<sup>82</sup> Shkelja e ligjeve federale të pornografisë fëmijërore konsiderohet si një ndër krimet më të rënda në SHBA, dhe për këto krime janë të parapara dënimet më të rënda ligjore.

Seksioni 2251 i referohet shfrytëzimit seksual të fëmijëve, duke e përcaktuar si vepër penale „përdorimin e një të mituri në pornografi me fëmijë”. Sipas këtij seksioni do të dënohet personi që punëson, përdor, bind, nxit, josh, ose detyron ndonjë të mitur të që të angazhohet; ose transporton ndonjë të mitur në tregtinë ndërshtetërore ose të huaj, ose në çdo territor të SHBA, me qëllim që i mituri të përfshihet në ndonjë akt të qartë seksual me synim të krijimit të përshkrimit vizual të aktit të tillë.<sup>83</sup> Ky seksion, gjithashtu ndëshkon prindërit e fëmijëve ose kujdestarët ligjor të tyre, të cilët me vetëdije lejojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë në materiale

---

<sup>79</sup> Child Pornography: Constitutional Principles and Federal Statutes 95-406, 2008, [https://www.everycrsreport.com/files/20081010\\_95-406\\_9790e689507a050f4a10bb96fd754748d03509.pdf](https://www.everycrsreport.com/files/20081010_95-406_9790e689507a050f4a10bb96fd754748d03509.pdf)

<sup>80</sup> U.S. Department of Justice, 950 Pennsylvania Avenue, NW, Washington, DC 20530-0001 <https://www.justice.gov/criminal-ceos/child-pornography> (qasja e fundit më 29.09.2021)

<sup>81</sup> Po aty.

<sup>82</sup> 18 U.S.C. §§ 2252.

<sup>83</sup> 18 U.S.C. §§ 2251.

me përmbajtje pornografike.<sup>84</sup> Seksioni 2251A parasheh dënim me burgim minimum 30 vjet, për çdo prind, kujdestar ligjor ose person tjetër që ka kujdestarinë e fëmijës, i cili shet fëmijën, me qëllim të shfrytëzimit të fëmijës në performanca pornografike. Gjithashtu ky seksion, e përcakton si vepër penale publikimin me vetëdije të njoftimeve ose reklamave me pornografi fëmijërore. Sa i përket mjeteve për transportimin (shpërndarjen) e materialeve pornografike fëmijërore, në këtë seksion potencohet çdo lloj mjeti për transport, përfshirë transportin me kompjuter ose me postë.<sup>85</sup>

Seksioni 2256 e përcakton kuptimin e akteve eksplicite seksuale, si ato vepra në të cilat të miturit nuk mund të përshkruhen se janë të përfshirë në:

1) marrëdhëniet seksuale, përfshirë ato gjenital-gjenital, oral-gjenital, anal-gjenital, ose oral-anal, qoftë midis personave të gjinisë së njëjtë apo të kundërt;

(2) bestializëm;

(3) masturbim;

(4) abuzim sadist ose masokist; ose

(5) Shfaqja e organeve seksuale të çdo personi me qëllim të zgjimit të lakmisë apo epshit seksual.<sup>86</sup>

Në vijim janë analizuar autoritetet e hetimit të pornografisë fëmijërore në SHBA.

## **2.2. Njësia Hetimore e Teknologjisë së Lartë**

Njësia Hetimore e Teknologjisë së Lartë (HTIU) inicon hetimet dhe kryen ekspertiza kriminalistike mbi provat kompjuterike në rastet federale që përfshijnë krime të shfrytëzimit të fëmijëve në internet. HTIU është krijuar për të siguruar ekspertizën më të saktë, të azhurnuar në çështjet kriminalistike të kompjuterit. Specialistët e kriminalistikës kompjuterike të HTIU,

---

<sup>84</sup> 18 U.S.C. §§ 2251.

<sup>85</sup> 18 U.S.C. §§ 2251A.

<sup>86</sup> 18 U.S.C. §§ 2256.

ndihmojnë agjentët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët në hetimin dhe ndjekjen e krimeve të shfrytëzimit të fëmijëve të kryer nga kompjuteri dhe interneti.<sup>87</sup>

### **2.3. Child Exploitation and Obscenity Section**

CEOS është krijuar në vitin 1987, me qëllim për të luftuar dhe për të parandaluar prodhimin, shpërndarjen dhe posedimin e pornografisë fëmijërore në internet. Avokatët e CEOS bashkëpunojnë me Njësinë Hetimore të Teknologjisë së Lartë (HTIU), Byronë Federale të Hetimit (FBI), Zyrat e Prokurorit të SHBA-së dhe Qendrën Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar (NCMEC) për të luftuar fuqishëm këtë krim duke hetuar dhe ndjekur penalisht shkelësit e ligjeve federale të pornografisë fëmijërore.<sup>88</sup>

### **2.4. Detyrimet e ofruesve të shërbimit të internetit në lidhje me pornografinë fëmijërore-ISP**

Ofruesi i shërbimit të internetit (ISP) është një organizatë që ofron shërbime të ndryshme për qasje, përdorim ose pjesëmarrje në internet. Ofruesit e shërbimit të internetit (ISP) zënë vendin kryesor në shoqërinë moderne, pasi që ata sigurojnë qasje në internet për miliona njerëz në mbarë botën, gjë që lejon komunikimin e menjëhershëm, shkëmbimin e ideve dhe qasje të lehtë te një numër të madh informacionesh.

Për shkak të rolit të tyre unik në lehtësimin e komunikimit dhe tregtisë në internet, në luftën kundër pornografisë fëmijërore, disa shtete kërkojnë nga ISP të raportojnë pornografi të dyshuar me fëmijë në internet. Kështu në bazë të seksionit 2258A të titullit të 18 të Ligjit Federal të SHBA, ISP-ve u kërkohet që të dorëzojnë raporte në Qendrën Kombëtare të Fëmijëve të Humbur ose të Shfrytëzuar (NCMEC), kur marrin njohuri për faktet ose rrethanat që përfshijnë:

- Shfrytëzimin seksual të fëmijëve;

---

<sup>87</sup> U.S. Department of Justice, 950 Pennsylvania Avenue, NW, Washington, DC 20530-0001  
<https://www.justice.gov/criminal-ceos/child-pornography>

<sup>88</sup> Po aty.

- Shitjen ose blerjen e fëmijëve;
- Prodhimin ose shpërndarjen e pornografisë fëmijërore dhe
- Faqet e internetit të krijuara për të mashtruar fëmijët që të shikojnë pornografi ose materiale të tjera të turpshme.

Raporti duhet të përbëjë të dhënat sa i përket përdoruesit individual, përfshirë adresën e tij të emailit ose IP adresën; përshkrimi i ngjarjes kur dhe si ka ndodhur si dhe lokacionin.<sup>89</sup>

### 3. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Suedisë

Pornografia fëmijërore në Suedi është rregulluar në Kodin Penal Suedez- Brottsbalken (BrB), në kapitullin e 16 në kuadër të krimeve kundër rendit publik, seksioni 10a. Sipas seksionit 10a, ai i cili<sup>90</sup>:

1. përshkruan një fëmijë në një imazh pornografik;
2. shpërndan, transferon, ekspozon ose mundëson tjetrin që të posedojë një imazh të tillë të një fëmije;
3. siguron për vete apo ofron për tjetrin një imazh të tillë të një fëmije;
4. ndërmjetëson në shit-blejen e imazheve të tilla të fëmijëve ose në ndonjë mënyrë tjetër të ngjashme lehtëson trafikimin e imazheve të tilla;
5. posedon një imazh të tillë të një fëmije ose shikon një imazh të tillë në të cilin ata kanë marrë pjesë, është fajtor për një vepër të pornografisë fëmijërore dhe dënohet me burgim jo më shumë se dy vjet.

Në këtë dispozitë, është përcaktuar edhe kuptimi i nocionit „fëmijë”, i cili konsiderohet si një person zhvillimi i pubertetit i të cilit nuk është i plotë ose i cili është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

<sup>89</sup> John DiGiacomo, Internet Server Provider Requirements to Report Child Pornography, 2008, <https://revisionlegal.com/internet-law/internet/report-child-pornography/> (qasja e fundit më 29.09.2021).

<sup>90</sup> The Swedish Criminal Code- Brottsbalken SFS 1962:700, FS 2021:397, 10a §.



Pra, kjo dispozitë na le të kuptojmë që në Suedi konsiderohet e kundërligjshme shikimi, posedimi, shpërndarja, mundësimi i ndonjë personit tjetër që të posedoj pornografi fëmijërore, si dhe ndërmjetësimi dhe që dispozitat e kodit penal Suedez për krimet e pornografisë fëmijërore në të vërtetë nuk zbatohen për të gjithë fëmijët e përshkruar në materiale pornografike, por vetëm për fëmijët viktimë, zhvillimi i pubertetit i të cilëve nuk është i plotë, ose kur është e qartë se fëmija në fjalë është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

### **3.1. Masat për parandalimin e pornografisë fëmijërore sipas Aktit mbi përgjegjësinë për tabelat elektronike të njoftimeve (1998: 112)**

Edhe pse në kodin penal Suedez, pornografia fëmijërore si formë e krimit kibernetik nuk është përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, në Aktin mbi përgjegjësinë për tabelat elektronike të njoftimeve ka rregulla që synojnë të parandalojnë përhapjen e këtij krimi.

Tabelat elektronike të njoftimeve, (Electronic bulletin boards- BBS) janë sisteme komunikimi në internet, që mundësojnë përdoruesve të internetit të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë elektronike. Sipas aktit të lartpërmendur, ofruesit e BBS janë të detyruar që ti mbikëqyrin përmbajtjen e mesazheve elektronike në formën e tekstit apo të zërit, imazheve, ose informacioneve të tjera. Ata janë të detyruar që të mënjanojë, ose në ndonjë mënyrë tjetër të parandalojnë përhapjen e mesazheve, nëse është e qartë se janë me përmbajtje pornografike me fëmijë.<sup>91</sup>

### **3.2. Masat për bllokimin e faqeve të internetit**

Bllokimi i faqeve të internetit me përmbajtje pornografike me fëmijë në Suedi bëhet në bashkëpunim vullnetar midis Policisë dhe Ofruesve të Shërbimeve të Internetit (ISP).

Procedura e bashkëpunimit midis policisë dhe ISP, fillon kur deri te policia në ndonjë nga mënyrat e informimit, arrijnë të dhënat mbi ekzistencën e ndonjë uebfaqes me përmbajtje

---

<sup>91</sup> Act on Responsibility of Electronic Bulletin Boards (1998:112).

pornografike me fëmijë. Policia gjithashtu mund të informohet nga organet e ndryshme, si Europoli, Interpoli, organizatat për të drejtat e fëmijëve ose nga qytetarët. Pas verifikimit të informacioneve nga policia, të dhënat më pas ndahen me Ofruesit e Shërbimeve të Internetit të cilët bëjnë aranzhimet teknike për bllokimin e uebfaqeve të tilla. Në procedurën për të verifikuar që faqja e internetit përmban materiale pornografike me fëmijë, Policia kontrollon gjithashtu lokacionin e uebfaqes. Vlen të theksohet se, faqet e internetit me përmbajtje pornografike fëmijërore do të bllokohen dhe do të bëhen të paarrtshme në Suedi pavarësisht nëse faqja ndodhet brenda apo jashtë BE -së. Në raste kur lokacioni i uebfaqes ndodhet jashtë territorit të Suedisë, atëherë informohen organet kompetente në vendin ku ndodhet uebfaqja.<sup>92</sup>

### **3.2. Qendra Suedeze e Krimin Kibernetik**

Në vitin 2015, Policia Suedeze ka formuar një Qendër të Krimin Kibernetik (SC3) me qëllim kryesor të ngritjes së kapaciteteve në të gjithë policinë për të hetuar të gjitha format e krimin kibernetik. Qendra ka njësinë e vet të hetimit që merret me mbikëqyrjen në internet, mbledhjen automatike të informacionit në mediat sociale dhe sigurimin e faqeve të internetit. Sa i përket parandalimit të pornografisë fëmijërore, qendra ka krijuar njësitë të specializuara që merren ekskluzivisht me hetimin e materialeve me përmbajtje të abuzimit seksual të fëmijëve.<sup>93</sup>

### **4. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Turqisë**

Në kodin penal të Turqisë pornografia fëmijërore, është definuar si përfshirja e fëmijëve në materiale të turpshme. Kështu sipas paragrafit (3) të nenit 226 i kodit penal të Turqisë, personi që përdor një fëmijë në prodhimin e materialeve të turpshme të shkruara ose audio-vizuale, dënohet me dënim me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet dhe me gjobë gjyqësore deri në

---

<sup>92</sup> Council of the European Union, Evaluation Report on the seventh round of mutual evaluations "The practical implementation and operation of European policies on prevention and combating cybercrime" - Report on Sweden, 8188/1/17 REV 1 RESTREINT UE/EU RESTRICTED dated: 18 May 2017, fq.20.

<sup>93</sup> Po aty, fq.20.

pesë mijë ditë.<sup>94</sup> Dispozita në vazhdim potencon që, çdo person që përcjell, kopjon ose ofron për shitje një material të tillë ose që shet, transporton, ruan, eksporton, posedon një material të tillë, do të dënohet me dënim me burgim prej dy deri në pesë vjet dhe me gjobë gjyqësore deri në pesë mijë ditë. Sipas nenit 6 paragrafi (1) pika a) fëmijë konsiderohet çdo person që nuk ka mbushur 18 vjeç.

Kjo dispozitë na le të kuptojmë që në kodin penal të Turqisë, vepra penale e pornografisë fëmijërore, përcaktohet si materiale të turpshme me fëmijë, si edhe është inkriminuar prodhimi i materialeve të tilla të shkruara ose audio-vizuale, kopjimi, shitja, transportimi, ruajtja, eksportimi, si dhe posedimi materialeve të turpshme me fëmijë. Por është shqetësues fakti që, nuk është përcaktuar se çfarë nënkuptohet me materiale të turpshme nën të cilat janë të përfshirë fëmijët si dhe nuk janë përcaktuar llojet e pornografisë fëmijërore.

#### **4.1 Departamenti i luftimit të krimit kibernetik**

Përkundër faktit që në kodin penal të Turqisë nuk është inkriminuar pornografia kibernetike fëmijërore, ajo konsiderohet e kundërligjshme. Hetimi i pornografisë fëmijërore si formë e krimit kibernetik, ashtu edhe hetimi i të gjitha veprave penale në fushën e teknologjive të informatikës, në Republikën e Turqisë kryhet nga Departamenti për luftën kundër krimit kibernetik, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Departamenti përqëndrohet në 5 qëllime kryesore, si:

- 1) Luftimi i krimit kibernetik;
- 2) Rritja e ndërgjegjësimit në shoqëri për krimet kibernetike;
- 3) Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimit kibernetik;
- 4) Vlerësimi i kërcënimeve të krimit kibernetik kundër Turqisë, si dhe kryerja e analizave të nevojshme dhe për të parandaluar këto kërcënime;

---

<sup>94</sup> Türk Ceza Kanunu 5237, „Kabul Tarihi: 26/9/2004. Yayınlandığı R.Gazete: Tarih: 12/10/2004 Sayı:2561, neni 226, paragrafi (3).

5) Trajnimi i hetuesve ekspertë dhe personelin e informatikës kriminalistike në luftën kundër krimin kibernetik;

6) Rritja e kapacitetit për të luftuar krimin kibernetik duke ndjekur dhe duke përdorur zhvillimet teknologjike.<sup>95</sup>

## **5. Pornografia fëmijërore në vendet e rajonit ballkanik**

### **5.1. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Shqipërisë**

Vepra penale e pornografisë fëmijërore, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë parashihet në nenin 117. Sipas nenit 117 ndalohet prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë fëmijërore, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dhe për këtë veprë penale është paraparë dënim me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.<sup>96</sup> Si mënyra të kryerjes si veprës penale të pornografisë fëmijërore në këtë dispozitë, po ashtu parashihet edhe rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmijë për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dhe për këtë veprë penale parashihet dënim me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Si që shihet nga neni 117 i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë, është dhënë një përkufizim për pornografinë fëmijërore në përgjithësi, jo edhe për pornografinë fëmijërore si formë e krimin kibernetik, gjegjësisht kryerjen e kësaj veprë penale me ndihmën e teknologjisë së informatikës.

Me qëllim të përcaktimit si veprë penale të pornografisë fëmijërore si formë e krimin kibernetik, në vitin 2008 me ligjin nr. 9859, me datë 21.01.2008, në kodin penal të Republikës së Shqipërisë, u shtua paragrafi i dytë i nenit 117 të këtij ligji, me këtë përmbajtje: „Përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në

---

<sup>95</sup> T.C. İçişleri Bakanlığı Emniyet Genel Müdürlüğü -Siber Suçlarla Mücadele Daire Başkanlığı, 2019, <https://www.egm.gov.tr/siber/hakkimizda2> (qasja e fundit më 03.10.2021)

<sup>96</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, neni 117.

internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.”<sup>97</sup>. Kështu me përmirësimin e Kodit Penal në vitin 2008, është inkriminuar edhe forma më e rrezikshme e këtij krimi, e cila kryhet me anë të internetit.

Edhe pse janë të përcaktuara format e kryerjes së veprës penale të pornografisë fëmijërore, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë nuk është përkufizuar se çfarë nënkuptohet me këtë vepër penale, gjegjësisht nuk është definuar se cilat materiale konsiderohet si materiale pornografike me fëmijë, si dhe nuk janë të përcaktuara llojet e pornografisë.

Hetimi i krimeve kibernetike përfshirë edhe pornografinë kibernetike fëmijërore në Republikën e Shqipërisë, bëhet nga Njësia “C” për Hetimin e Krimeve Kibernetike në Policinë e Shtetit.<sup>98</sup>

Sa i përket kontributit të Shqipërisë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi online, vlen të përmendet „Platforma kombëtare për sigurinë e fëmijëve në internet”. Qasja në këtë platformë arrihet përmes uebfaqes [www.isigurt.al](http://www.isigurt.al). Kjo platformë përmban informacione, manuale, udhëzues për prindërit, mësuesit, profesionistët që punojnë me ose për fëmijët, me qëllim për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe shfrytëzimi online. Platforma ka për qëllim që të nxisë raportimin e faqeve të paligjshme dhe përmbajtjet e padëshiruara në internet. Për të arritur këtë qëllim, në linkun e sipërcituar është krijuar një rubrikë „RAPORTO!”. Kjo rubrikë mundëson raportimin anonim dhe konfidencial të përmbajtjeve të papërshtatshme dhe të paligjshme të materialeve të hasura në internet.<sup>99</sup> Sipas të dhënave të Platformës, vetëm për vitin 2020 për shkak të pandemisë globale të Covid-19, numri i faqeve të raportuara të pornografisë fëmijërore ka shënuar një shifër rekord prej 6273 faqe, ose 600-fish më shumë krahasuar me një vit më parë.<sup>100</sup>

---

<sup>97</sup>Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9859, dt. 21.10.2008.

<sup>98</sup> Policia e shtetit, Republika e Shqipërisë <https://www.asp.gov.al/departamenti-per-policine-kriminale/> (qasja e fundit më 05.10.2021).

<sup>99</sup> Platforma kombëtare për sigurinë e fëmijëve në internet, <https://www.isigurt.al/rreth-nesh/misioni-dhe-vizioni> (qasja e fundit 05.10.2021).

<sup>100</sup> Platforma kombëtare për sigurinë e fëmijëve në internet, <https://www.isigurt.al/lajme/isigurtal-40-e-faqeve-pornografike-te-raportuara-gjate-vitit-2020-jane-me-femijeve-shqiptare> (qasja e fundit më 05.10.2021).

## 5.2. Pornografia fëmijërore në legjislacionin e Kosovës

Pornografia fëmijërore në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, është përcaktuar në kapitullin XX me titull „Veprat penale kundër integritetit seksual”. Kështu sipas nenit 225, pornografi me fëmijë nënkupton „çfarëdo pamje vizuale apo shfaqje ose pasqyrim vizual, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyre elektronike, mekanike apo me mjete tjera, që paraqet ose pasqyron:

1. gjenitalet (vagjina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale;
2. një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;
3. një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;
4. pamje realiste të një fëmije joekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar ”.<sup>101</sup>

Si veprime të kryerjes së pornografisë fëmijërore përcaktohen edhe shitja, shpërndarja, promovimi, shfaqja, transmetimi, ofrimi ose vënia në dispozicion, sigurimi për vetveten apo personin tjetër si dhe posedimi i pornografisë fëmijërore.<sup>102</sup>

Si që shihet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, është e përcaktuar kuptimi i veprës penale të pornografisë fëmijërore, si dhe format e manifestimit të saj. Pra, në Kodin penal të Kosovës janë inkriminuar të gjitha llojet e pornografisë fëmijërore përfshirë edhe atë virtuale të kryer nga ana e kompjuterit. Mirëpo nuk është përcaktuar mjete i kryerjes së kësaj vepre penale me ndihmën e teknologjisë së informatikës.

---

<sup>101</sup> Kodi Penal NR. 06/L-074 i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, /Nr.2/14 Janar 2019, Prishtinë, neni 225.

<sup>102</sup> Po aty, neni 232.

Edhe pse realisht shpërndarja, shitja, shfaqja, promovimi, transmetimi ose vënia në dispozicion janë veprime me të cilat kryhet vepra penale e pornografisë fëmijërore sipas nenit 225 pa marrë parasysh se me të cilat mënyra dhe mjete kryhet, prapëseprapë është e domosdoshme të inkriminohet mjete i kryerjes së këtyre formave me anë të teknologjisë së informatikës ose të internetit.

Hetimi i krimeve kibernetike në Kosovë kryhet nga Sektori i Hetimeve të Krimeve Kibernetike, i cili funksionon në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar.<sup>103</sup>

## **6. Pornografia fëmijërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

### **6.1. Pornografia fëmijërore në Kodin penal të RMV**

Me pornografinë fëmijërore sipas Kodit Penal të RMV-së, nënkuptohet „materiali pornografik i cili në mënyrë vizuale tregon veprime të dukshme seksuale me të mitur, apo veprime të dukshme seksuale me person i cili duket si i mitur, apo fotografi reale që tregojnë veprime të dukshme seksuale me të mitur apo e tregojnë të miturin ose personin e rritur i cili duket si i mitur në një gjendje të dukshme seksuale”.<sup>104</sup>

Veprat penale lidhur me pornografinë fëmijërore në Kodin Penal të RMV-së, janë përcaktuar në kapitullin XIX, në kuadër të veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor.

Fillimisht, sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga materialet pornografike vlen të përmendet neni 193 i kodit penal të RMV-së, në të cilën është përcaktuar vepra penale „Ekspozimi i materialit pornografik fëmijës”. Këtë vepër penale konsiderohet se e kryen „ai i cili fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet do t’i shes, tregoj apo me ekspozim publik në mënyrë tjetër do t’ia bëj të arritshme fotografitë, sendet audio-vizuale me përmbajtje pornografike ose do t’i tregojë

---

<sup>103</sup> Policia e Kosovës, Departamenti i hetimeve <https://www.kosovopolic.com/departamentet/departamenti-i-hetimeve/>

<sup>104</sup> Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr: 37/1996, neni 122 pika 24.

shfaqje pornografike do të dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet” (paragrafi 1), ndërsa nëse „vepra është kryer përmes mjeteve të informimit publik, kryerësi do të dënohet me burgim prej 3 deri në 5 vjet” (paragrafi 2). Me dënim të njëjtë do të dënohet edhe „ai që do të keqpërdor fëmijën i cili ka mbushur 14 vjet për përpunimin e fotografive audiovizuale ose sende tjera me përmbajtje pornografike ose për shfaqje pornografike, si dhe ai që merr pjesë në shfaqjen” (paragrafi 3), ndërsa nëse fëmija është nën 14 vjet kryerësi do të dënohet me burgim së paku 4 vjet (paragrafi 4). Me dënim me burg së paku 8 vjet do të dënohet „ai i cili do të detyrojë fëmijën i cili ka mbushur 14 vjet që të përpunojë dhe të incizojë fotografi apo sende tjera me përmbajtje pornografike apo për shfaqje pornografike” (paragrafi 5), ndërsa nëse fëmija nuk ka mbushur 14 vjet, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim (paragrafi 6).<sup>105</sup> Siç po shihet ky nen ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga tregimi i materialeve pornografike, sepse mendohet që kryerësi e kryen këtë vepër me qëllim të kënaqjes së epsheve seksuale.

Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga pornografia fëmijërore, i referohemi nenit 193-a ku është inkriminuar vepra penale „Prodhimi dhe disturbimi i pornografisë fëmijërore”. Në bazë të këtij neni, „ai i cili prodhon pornografi fëmijërore me qëllim të distribuimit të saj, e mbartë, e ofron apo në mënyrë tjetër e bën të arritshme pornografinë fëmijërore, do të dënohet me së paku 5 vjet burgim” (paragrafi 1), ndërsa „ai i cili furnizon pornografi fëmijërore për vete apo për tjetër kë, apo posedon pornografi fëmijërore, do të dënohet me dënim me burgim prej pesë deri në tetë vjet (paragrafi 2).<sup>106</sup>

Pra në bazë të nenit neni 193-a, si veprime të kryerjes së veprës penale të pornografisë fëmijërore parashihen prodhimi pornografisë fëmijërore me qëllim të disturbimit, mbartja, ofrimi apo bërja e arritshme të pornografisë fëmijërore, si dhe furnizimi apo posedimi i pornografisë fëmijërore.

Pornografia fëmijërore si formë e krimit kibernetik në Kodin Penal të RMV-së, është inkriminuar në paragrafin e tretë të nenit 193-a. Kështu veprat e lartpërmendura të paragrafit

---

<sup>105</sup> Po aty, neni 193.

<sup>106</sup> Po aty, neni 193-a.



(1) dhe (2) nëse kryhen përmes sistemit kompjuterik apo ndonjë mjet tjetër për komunikim masiv, kryerësi do të dënohet me së paku tetë vjet burgim (paragrafi 3). Pra, me këtë paragraf nënkuptohet vepra penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore përmes sistemit kompjuterik”.<sup>107</sup>

Po ashtu vlen të theksohet se në kuadër të këtij kapitulli, kryesisht në nenin 193-b është inkrimuar edhe joshja e fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet në akt seksual apo në veprim tjetër seksual. Këtë vepër penale konsiderohet se e kryen „ai i cili përmes mjeteve kompjuterike-komunikimeve me caktim të takimit apo në mënyrë tjetër josh fëmijën i cili nuk i ka mbushur 14 vjet në prostitucion apo në ndonjë veprim tjetër seksual apo në prodhim të pornografisë fëmijërore dhe nëse me qëllimin e tillë është realizuar takimi i drejtpërdrejtë me të miturin, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet”.<sup>108</sup>

Sipas dispozitave të lartpërmendura mund të konkludohet që, për pornografinë fëmijërore në RMV nuk merret mosha e pjekurisë seksuale, por për këtë vepër penale merret për bazë mosha madhore e cila është 18 vjet. Mosha e pjekurisë seksuale merret për bazë vetëm për veprën penale „Ekspozimi i materialit pornografik fëmijës”, „Joshja e fëmijës” si dhe „Sulm seksual ndaj fëmijës që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç”.

Është shqetësues fakti që, edhe pse janë të inkriminuara gati të gjithë format e manifestimit, nuk janë inkrimuar llojet e pornografisë fëmijërore, si pornografia virtuale dhe ajo e modifikuar.

Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ekziston Sektori për krimin kompjuterik dhe forenzikë kompjuterike, i cili është kompetent për hetimin e të gjitha krimeve kibernetik.<sup>109</sup>

---

<sup>107</sup> По аты, нени 193-а, параграфи (3).

<sup>108</sup> По аты, нени 193-б.

<sup>109</sup> Краток водич за обвинители- "Обезбедување докази во електронска форма од меѓународни и домашни интернет сервис провајдери".

## 6.2. Regjistri i personave të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë

Si një masë parandaluese të pornografisë fëmijërore në RMV konsiderohet regjistrimi i personave të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve në një regjistër të veçantë dhe publik.

Në vitin 2012, për parandalimin dhe luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë, Parlamenti i RMV-së, miratoi „Ligjin për regjistrin e veçantë për persona të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili” (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 11/2012, 2012). Në bazë të këtij ligji u krijua një regjistër online, me të dhënat personale të personave të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor të kryera ndaj fëmijëve, përfshirë edhe „Ekspozimi i materialit pornografik fëmijës (neni193)” dhe „Prodhimi dhe disturbimi i pornografisë fëmijërore (neni 193-a)”. Regjistri ka akses të hapur, dhe të gjithë mund të shohin personat që janë të dënuar për pedofili në vendin tonë.<sup>110</sup>

Regjistri për pedofili është i disponueshëm në faqen e internetit [www.registarnapedofili.mk](http://www.registarnapedofili.mk). Regjistri online përmban të dhëna personale të të dënuarve si: emri dhe mbiemri, datëlindja, adresa e vendbanimit, vepra penale për të cilën është dënuar dhe një fotografi.<sup>111</sup>

---

<sup>110</sup> Ratkoceri Vedije, Special register of child sexual abusers and pedophiles as a necessary preventive measure, ILIRIA International Review – Vol 11, No 1 (2021), fq.199.

<sup>111</sup> Ligji për Regjistrin e veçantë të personave të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili, Gazeta Zyrtare e RMV-së, Nr.11/2012, neni 4.

### 6.3. Të dhënat statistikore për veprën penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore përmes sistemit kompjuterik” në RMV

Enti Shtetëror Statistikor është burim i vetëm në RMV, ku janë të publikuara të dhënat statistikore vjetore të personave të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar, për të gjitha veprat, të cilat në Kodin Penal janë të përcaktuar si vepra penale. Por, të dhënat statistikore për persona të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar, sa i përket llojit të veprës penale dhe llojit të sanksionit të shqiptuar si dhe të dhënave të tjera të kryerësve të veprave penale, janë të publikuara vetëm për një periudhë të caktuar kohore, kryesisht prej vitit 2008 deri në vitin 2017.<sup>112</sup>

Në publikimet e Entit Shtetëror Statistikor prej vitit 2008 deri në vitin 2017, të dhënat sa i përket veprës penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik”, ekzistojnë vetëm në publikimet e vitit 2010, 2011 dhe 2012. Andaj në vazhdim do të paraqiten të dhënat vetëm për këtë periudhë trevjeçare.

| Tabela nr. 2  |   |                                |  |
|---|---|--------------------------------|--|
| Numri i fëmijëve të paraqitur si kryerës i veprës penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore përmes sistemit kompjuterik” për vitin 2010 <sup>113</sup> |   |                                |  |
| Gjithsej  | Propozim për shqiptimin e masës ndëshkimore | Procedura nuk është e iniciuar | Procedura përgatitore është ndërpritur |
| 3   | 2   | /                              | 1                                      |

Në tabelën me nr. 2, janë të paraqitura të dhënat e vetme për vitin 2010 nga Enti Shtetëror Statistikor. Ashtu si që shihet në tabelë është paraqitur numri i fëmijëve të paraqitur si kryerës i veprës penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore përmes sistemit kompjuterik” për vitin 2010, ku gjithsej janë paraqitur 3 fëmijë, për 2 fëmijë është propozuar shqiptimi i masës ndëshkimore dhe 1 prej tyre procedura përgatitore është ndërpritur. Të dhëna tjera sa i përket numrit të personave të paraqitur, të akuzuar ose të dënuar për veprën penale të lartë përmendur nuk ka janë të paraqitura.

<sup>112</sup> Enti Statistikor i RMV-së <https://www.stat.gov.mk/PublikaciiPoOblast.aspx?id=43&rbrObl=6>

<sup>113</sup> Enti Statistikor i RMV-së-„Kryerësit e veprave penale në vitin 2010”, 2.4.11.15 698, Shkup, tetor, 2011, fq. 109.

Në vitin 2011 vetëm një person i moshës madhore është paraqitur si kryerës si veprës penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore përmes sistemit kompjuterik”, dhe i njëjti është dënuar me burgim 1-2 vjet.<sup>114</sup>

Ndërsa në vitin 2012 vetëm 2 persona madhorë janë paraqitur si kryerës i veprës penale të lartë përmendur, dhe kundër tyre është ngritur aktakuzë. Të dhëna të tjera sa i përket gjykimit dhe dënimit të atyre personave nuk gjenden.<sup>115</sup>

Përkundër faktit të mungesës së të dhënave nga Enti shtetëror Statistikor dhe mungesës së praktikës gjyqësore në vendin tonë në lidhje me këtë vepër penale, nuk mund të arrijmë në përfundim se pornografia fëmijërore nuk është prezente në RMV. Falë internetit dhe zhvillimeve teknologjike si dhe mungesës së ekspertëve special në këtë fushë, vështirësohet identifikimi dhe hetimi i këtij krimi.

---

<sup>114</sup> Enti Statistikor i RMV-së-„Kryerësit e veprave penale në vitin 2011”, 2.4.12.09 724, Shkup, qershor, 2012, fq. 39.

<sup>115</sup> Enti Statistikor i RMV-së-„Kryerësit e veprave penale në vitin 2012”, 2.4.13.11 754, Shkup, qershor, 2013, fq. 15.

## KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Duke e marrë parasysh zhvillimin e hovshëm të teknologjisë së informatikës, shpërndarja online e imazheve me përmbajtje abuzive të fëmijëve është rritur në mënyrë dramatike gjatë viteve të fundit.

Parandalimi i pornografisë kibernetike fëmijërore, shpesh përballlet me vështirësi për shkak të mungesës së njohurive sa i përket kuptimit të saj, format e manifestimit si dhe për kryerësit. Andaj, në këtë punim të magistraturës është analizuar në mënyrë të hollësishme fenomeni i pornografisë kibernetike fëmijërore.

Për ti dhënë një kuptim më të qartë për objektin e studimit të temës, në fillim është analizuar krimi kibernetik në mënyrë të përgjithshme. Gjatë trajtimit të kuptimit të krimit kibernetik është konkluduar që nuk ekziston një përkufizim unik, të përbashkët mes autorëve si dhe mes akteve ndërkombëtare. Gjithashtu, ekzistojnë terme të ndryshme edhe për identifikimin e krimeve të kryera në hapësirën kibernetike, siç janë: „krimi kibernetik”; „krimi elektronik”; „krimi i teknologjisë së lartë”; „krimi i digjitalizuar” si dhe „krimi kompjuterik”, ku teknologjia informatike luan rolin kryesor në realizimin e krimit. Edhe pse ekzistojnë terme të ndryshme për identifikimin e krimeve të kryera në hapësirën kibernetike, ashtu si që është theksuar edhe më lartë, në këtë punim është përdorur termi i „Krimit kibernetik”, pasi që ky term, është përdorur edhe nga Konventa Budapestit për Krimin Kibernetik. Termi „krimi kibernetik”, gjithashtu preferohet edhe nga shumë autorë të tjerë, sepse mendohet që ky term i mbulon të gjithë krimet që mund të kryhen në hapësirën kibernetike, pa mos e caktuar mjetin e kryerjes së krimit, si që është termi „krimi kompjuterik”. Krimet në hapësirën kibernetike nuk kryhen vetëm me anë të kompjuterëve, por janë edhe mjetet tjera teknologjike si psh. telefonat e mençur, si dhe me zhvillimin e teknologjisë do të krijohen lloje të reja të mjeteve.

Gjatë trajtimit të krimit kibernetik, janë analizuar tre karakteristikat më të rëndësishme të tij, si: kufijtë, hetimi dhe anonimiteti i krimit kibernetik. Duke i marrë parasysh këto veçori, mund të konkludohet që interneti shtrihet përtej kufijve gjeografike dhe kriminelët mund të kryejnë sulme të sofistikuara pa afërsi fizike me vendndodhjen e një krimi. Kështu, siguria

kibernetike paraqet një problem ndërkombëtar që kërkon bashkëpunim aktiv midis shteteve si për identifikimin e krimeve kibernetike po ashtu edhe për identifikimin e autorëve të tyre. Për bashkëpunim ndërkombëtar janë mëse të nevojshme lidhja e marrëveshjeve bilaterale si dhe multilaterale mes shteteve dhe organizatave ndërkombëtare. Kështu vërtetohet hipoteza e dytë e këtij punimi, që mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar midis shteteve si dhe organizatave ndërkombëtare e vështirëson parandalimin e këtij kriminaliteti.

Objekt studimi i temës, pra *Pornografia Kibernetike Fëmijërore* është shtjelluar në mënyrë të hollësishme në kapitullin e dytë. Nga trajtimi i evolucionit të pornografisë fëmijërore vërehet se, ky fenomen ka qenë prezentë edhe mijëra vite më parë. Pra, e vetmja gjë që ka ndryshuar me kalimin e viteve, ka qenë forma e manifestimit të saj. Mijëra vite më parë, pornografia me fëmijë është manifestuar në portrete pikturore dhe të shkruara, ndërsa më pas në revista, magazina, libra dhe tani në epokën digjitale ajo manifestohet në internet. Dallimi kryesor në mes pornografisë klasike dhe kibernetike është se, pornografia klasike është manifestuar në hard-copy, ndërsa pornografia kibernetike manifestohet në hapësirën kibernetike. Interneti, në fakt nuk përdoret vetëm si një mjet për transmetimin e imazheve dhe videove me përmbajtje pornografike, por gjithashtu e lehtëson prodhimin, shpërndarjen dhe posedimin e saj dhe nga ana tjetër e vështirëson zbulimin dhe ndjekjen e saj.

Në këtë kapitull, janë analizuar edhe llojet specifike që i përkasin vetëm pornografisë kibernetike fëmijërore, pra „pornografia e krijuar nga kompjuteri”. Të tilla konsiderohen pornografia e modifikuar dhe pornografia virtuale apo fiktive. Këto lloje të pornografisë krijohen nga kompjuterët pa pasur nevojë për një fëmijë real për krijimin e imazheve të tilla.

Sa i përket formave të manifestimit, pornografia fëmijërore mund të kryhet në forma të ndryshme. Në këtë kapitull janë analizuar tre format themelore si: prodhimi, shkarkimi dhe shpërndarja e pornografisë. Në këtë pjesë, është bërë një trajtim i detajshëm, në funksion të dhënies së përgjigjes se kush janë krijuesit e imazheve pornografike, cilat janë pajisjet për regjistrimin e imazhe të tilla, kush janë shpërndarësit, vendet ku shpërndahen dhe shkarkohen imazhe të tilla.

Duke i marrë parasysh format manifestimit të pornografisë fëmijërore, është analizuar edhe tipologjia e kryerësve në bazë të motivit dhe natyrës së abuzimit të fëmijëve. Dikush has pornografi me fëmijë pa dashje, duke u përgjigjur spamëve, por më pas në vend që të fshijë vendos ta ruajë. Lloji tjetër i kryerësve janë ato të cilët vazhdimisht kërkojnë të shikojnë pornografi me fëmijë në internet, disa prej tyre bëhen edhe koleksionist duke mbledhur vazhdimisht imazhe. Janë të njohur edhe joshësit online, që vazhdimisht i kontaktojnë fëmijët përmes rrjeteve sociale, me qëllim që të kërkojnë nga ato të paraqesin imazhe të vetes, ose me qëllim të caktimit të ndonjë takimi për ti abuzuar seksualisht si dhe të krijojnë materiale pornografike. Në bazë të kësaj tipologjie, mund të konkludojmë që karakteristika e përbashkët e tyre është dëshira apo preferenca seksuale e tyre për fëmijët (përveç prodhuesve dhe shpërndarësve të cilët nuk kanë interes seksual për fëmijët, por i krijojnë dhe i shpërndajnë ato për përfitime financiare).

Sa i përket profilit të viktimave, paraqiten sikur vajzat ashtu edhe djemtë. Por në bazë hulumtimit, është konstatuar që, ashtu sikur edhe tek veprat tjera kundër lirisë dhe moralit gjinor, numri i fëmijëve viktimë të gjinisë femërore është më i lartë. Nga të dhënat statistikore konstatohet se fëmijët viktimë janë nga të gjitha grup moshat, përfshirë nga foshnjët deri tek fëmijët në pubertet. Sa i përket raportit të fëmijëve viktimë me viktimizuesit e tyre është konstatuar se numri më i lartë i abuzuesve të fëmijëve janë nga rrethi familjar i tyre.

Në kapitullin e katërt të punimit, në fillim është realizuar një analizë e përgjithshme të legjislacioneve të të gjitha shteteve në botë, sa i përket kontributit të tyre në luftën kundër pornografisë fëmijërore dhe mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë pjesë është vërtetuar hipoteza e parë e punimit, pasi që pornografia fëmijërore nuk është përcaktuar si vepër penale në 16 shtete në botë, ndërsa pornografia fëmijërore si formë e krimit kibernetik nuk është inkriminuar në 41 shtete në botë. Duke i marrë parasysh karakteristikat e krimit kibernetik, asnjë nga format e tij nuk mund të luftohet dhe të parandalohet me sukses, nëse nuk janë të inkriminuara në të gjitha shtetet sepse mungesa e tillë e inkriminimit e vështirëson bashkëpunimin ndërkombëtar.

Përmes analizës komperative, në mënyrë të detajuar është analizuar legjislacioni i SHBA-së, Suedisë, Turqisë, Kosovës, Shqipërisë dhe në fund i RMV-së. Krahas legjislacionit janë analizuar edhe autoritetet e hetimit të pornografisë fëmijërore. Kjo analizë komperative na dëshmon që, në SHBA dhe në Suedi funksionojnë institucione që merren enkas me hetimin e pornografisë fëmijërore kibernetike. Ndërsa në Turqi, Kosovë, Shqipëri dhe RMV, hetimi i pornografisë kibernetike bëhet varësisht sipas institucionit ku kryhen hetimet e të gjitha formave të krimit kibernetik.

Sipas të dhënave statistikore nga Enti Shtetëror Statistikor për veprën penale „Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik”, ekzistojnë të dhëna vetëm në publikimet e viteve 2010, 2011 dhe 2012. Bëhet fjalë vetëm për një person i moshës madhore i cili në vitin 2011 është dënuar me burg 1-2 vjet. Nga mungesa e të dhënave statistikore për vitet tjera, si dhe nga mungesa e rasteve të personave të dënuar nuk mund të konkludojmë që ky fenomen nuk është prezentë në shtetin tonë, por ajo që mund të konkludojmë është se numri i errët është shumë i lartë. Kjo ndodh për arsye se, në RMV së pari mungon një ligj i veçantë për krimin kibernetik, si dhe persona kompetente të trajnuar dhe të aftësuar për hetimin dhe identifikimin e krimeve dhe autorëve të tyre. Kështu vërtetohet edhe hipoteza e tretë e punimit.

Në bazë të rezultateve të arritura nga hulumtimi, në vijim janë dhënë disa rekomandime.

- Të përcaktohet si vepër penale pornografia fëmijërore në legjislacionin e çdo shteti, si dhe të inkriminohet kryerja e saj me anë të teknologjisë së informatikës.
- Përkufizimi i pornografisë fëmijërore duhet të përfshijë, së paku paraqitjen vizuale ose përshkrimin e një fëmije të përfshirë në akte eksplicite seksuale (reale ose të simuluar), si dhe të përcaktohen se cilat akte konsiderohen si akte eksplicite seksuale.
- Të inkriminohen të gjitha llojet e pornografisë fëmijërore, përfshirë pornografinë e modifikuar dhe pornografinë virtuale.
- Të inkriminohen të gjitha veprat me të cilat mund të kryhet pornografia fëmijërore, përfshirë: krijimi, shpërndarja, shkarkimi, shikimi, posedimi, printimi, postimi, publikimi, transmetimi apo dërgimi; vënia në dispozicion; shitja; importimi dhe eksportimi.



- Moshë e përkurisë seksuale mos të merret për bazë për pornografinë fëmijërore, sepse ky lloj i abuzimit seksual nuk mund të përfundojë kurrë plotësisht dhe viktimat do të vazhdojnë të viktimizohen gjatë gjithë jetës së tyre. Për këtë veprë penale duhet të merret parasysh moshë madhore, e cila është 18 vjet, sepse një person nën moshën 18 vjeç mund të jetë në gjendje të pranojë lirisht një marrëdhënie seksuale por ai person nuk e ka përkurinë të pranojë që të marr pjesë në pornografi.
- Me qëllim të zbulimit të imazheve pornografike me fëmijë, kompania teknologjike „Apple” më 08.06.2021 prezantoi një mjet të ri i quajtur „Apple CSAM” që do të skanojë iPhone-ët dhe pajisje të tjera Apple nëse kanë imazhe pornografike me fëmijë. Skenari „Apple CSAM” sa po të dedektojë ndonjë imazh të tillë në një pajisje, ai menjëherë do ta turbullojë imazhin dhe do t'i raportojë serverëve të Apple. Në luftë kundër pornografisë fëmijërore është e nevojshme që këtë lloj skanimi ta përdorin të gjithë kompanitë teknologjike, dhe më pas të dorëzojnë raporte policive kibernetike apo institucioneve tjera kompetente, varësisht shtetit në të cilën janë hasur materialet e tilla.
- Sipas rezultateve të hulumtimit është vërejtur që në SHBA dhe Suedi janë krijuar institucione të posaçme për kryerjen e hetimeve dhe ekspertizave kriminalistike mbi provat kompjuterike për veprat penale lidhur me pornografinë fëmijërore. Ndërsa në RMV ekziston vetëm një sektor në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili është kompetent për hetimin e krimit kibernetik. Andaj, është e nevojshme që në kuadër të policisë së jurisprudentës të formohet një Polici Kibernetike, që do të merret me hetimin dhe zbulimin e krimeve kibernetike. Nëpunësit të jenë ekspertë kriminalistikë në fushën e teknologjive informatike, si dhe vazhdimisht të trajnohen duke i ndjekur përditësimet e reja që shfaqen në fushën e krimit kibernetik.
- Për parandalimin e pornografisë me fëmijë në internet, është e domosdoshme që të merren masa edhe për bllokimin e faqeve të internetit. Bllokimi i këtyre faqeve bëhet në bashkëpunim midis Policisë dhe Ofruesve të Shërbimeve të Internetit (ISP). Andaj, policia duhet të kërkojnë nga ISP të raportojnë pornografi të dyshuar me fëmijë në internet, me qëllim që faqet e tilla të bllokohen dhe të zbulohen autorët e tyre.

## BIBLIOGRAFIA

### Libra dhe artikuj shkencor

- American Psychiatric Association (2000). Diagnostic and statistical manual of mental disorders, fourth edition, text revision, Washington, D. C.
- Bray Jesse D., Anonymity, Cybercrime, and the Connection to Cryptocurrency, Eastern Kentucky University, 2016.
- Caleb Beacham, Metamorphosis: Changing Oklahoma Law to Protect Children from Morphed Child Pornography, 55 Tulsa L. Rev. 311 (2020).
- Council of the European Union, Evaluation Report on the seventh round of mutual evaluations "The practical implementation and operation of European policies on prevention and combating cybercrime" - Report on Sweden, 8188/1/17 REV 1 RESTREINT UE/EU RESTRICTED dated: 18 May 2017.
- Fred S. Berlin, Denise Sawyer, Potential Consequences of Accessing Child Pornography Over the Internet and Who is Accessing It, 2012, 1532-5318 online DOI: 10.1080/10720162.2012.660429.
- Jochen Peter & Patti M. Valkenburg, Adolescents and Pornography: A Review of 20 Years of Research, The Journal of Sex Research, 2016.
- Kathryn C. Seigfried, Richard W. Lovely, Marcus K. Rogers - Online Child Pornography Behavior, New York, 2008.
- Kunz Michael & Wilson Patrick, Computer Crime and Computer Fraud, University of Maryland Department of Criminology and Criminal Justice, 2004.
- Laura Negredo and Óscar Herrero, Child pornography on the internet, Madrid, 2016. *Vol. 37(3)*.
- Najat M'jid Maalla, Report of the Special Rapporteur on the sale of children, child prostitution and child pornography, 2009, GE.09-14627 (E) 010909 040909.
- Nicholas Tsagourias, The legal status of cyberspace, Edward Elgar Publishing, 2015.

- Richard Wortley, Stephen Smallbone, Child Pornography on the Internet, U.S. Department of Justice, Office of Community Oriented Policing Services (COPS Office). 2006, ISBN: 1-932582-65-7.
- Rikki Solowey, „A Question of Equivalence: Expanding the Definition of Child Pornography to Encompass “Virtual” Computer-Generated Images, Vol.4 2002.
- Rogers Audrey, Child Pornography's Forgotten Victims, 28 Pace L. Rev. 847 (2008).
- Rutger Leukfeldt, The human Factor in cybercrime and cybersecurity, Netherlands, 2017, ISBN 978-94-6274-706-7.
- Stacey B. Steinberg, Sharenting: Children's Privacy in the Age of Social Media, 66 Emory L.J. 839 (2017).
- TOJET: The Turkish Online Journal of Educational Technology – January 2016, volume 15 issue 1, Prevalence and Impact of Cyberbullying in a Sample of Indonesian Junior High School Students.
- Tony Krone, A typology of online child pornography offending, Australian Institute of Criminology, 2004.
- Vedije Ratkoceri, Special register of child sexual abusers and pedophiles as a necessary preventive measure, ILIRIA International Review – Vol 11, No 1 (2021).
- Vedije Ratkoceri, Kastrimi kimik si sanksion penal, SEEU, 2008.
- Veton Vula & Mensut Ademi, Krimi Kompjuterik, Prishtinë, 2018.
- Wall David, Cybercrimes: New Wine, No Bottles?, Dartmouth Publishing Company, 2003.
- Wortley R. (2014) Child Pornography. In: Bruinsma G., Weisburd D. (eds) Encyclopedia of Criminology and Criminal Justice. Springer, New York, NY.
- Yusuf Uzunay & Mustafa Koçak, Child Pornography on Internet and the Challenges in Combating, Polis Bilimleri Dergisi Cilt: 7(I) Turkish Journal of Police Studies Vol: 7 (1).
- Краток водич за обвинители- "Обезбедување докази во електронска форма од меѓународни и домашни интернет сервис провајдери".

## Ligje dhe akte ndërkombëtare

- 10th UN Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders, 2000, A/CONF.187/10.
- Act on Punishment of Activities Relating to Child Prostitution and Child Pornography, and the Protection of Children (Act No.52 of May 26, 1999).
- Act on Responsibility of Electronic Bulletin Boards (1998:112).
- Child Pornography: Constitutional Principles and Federal Statutes 95-406, 2008.
- Convention on Cybercrime (CETS No.185), Budapest, 2001.
- Convention on the Rights of the Child 44/25, 1989.
- Council of Europe Convention on the Protection of Children against Sexual Exploitation and Sexual Abuse CETS 201, Lanzarote, 2007.
- Directive 2011/93/EU of the European Parliament and of the Council of 13 December 2011 on combating the sexual abuse and sexual exploitation of children and child pornography.
- Explanatory Report to the Convention on Cybercrime Budapest, 2001.
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr: 37/1996.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9859, dt. 21.10.2008.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995.
- Kodi Penal NR. 06/L-074 i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.2/14 Janar 2019, Prishtinë.
- Ligji për Regjistrin e veçantë të personave të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili, Gazeta Zyrtare e RMV-së, Nr.11/2012.
- Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the sale of children, child prostitution and child pornography A/RES/54/263, 2000.
- The Swedish Criminal Code- Brottsbalken SFS 1962:700, FS 2021:397.
- Türk Ceza Kanunu 5237,.Kabul Tarihi: 26/9/2004. Yayınlandığı R.Gazete: Tarih: 12/10/2004 Sayı:2561.

## Burime nga interneti

- Age of Consent in Japan, 2021, <https://www.ageofconsent.net/world/japan>
- Apeline Security, What is the origin of the word „cyber“? <https://alpinesecurity.com/blog/what-is-the-origin-of-the-word-cyber>
- Borges Esteban, Cyber Crime Investigation Tools and Techniques Explained, Security Trails, 2020, <https://securitytrails.com/blog/cyber-crime-investigation>
- Brandon Barnett, What is the Age of Consent in the United States?, 2016, <https://www.bhwlawfirm.com/legal-age-consent-united-states-map/>
- Computer and internet fraud, 2021, <https://www.impactlaw.com/criminal-law/white-collar/computer-internet-fraud>
- Enti Statistikor i RMV-së <https://www.stat.gov.mk/PublikaciiPoOblast.aspx?id=43&rbrObl=6>
- Enti Statistikor i RMV-së-„Kryerësit e veprave penale në vitin 2010”, 2.4.11.15 698, Shkup, tetor, 2011 [https://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.11.15\\_kor.pdf](https://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.11.15_kor.pdf)
- Enti Statistikor i RMV-së-„Kryerësit e veprave penale në vitin 2011”, 2.4.12.09 724, Shkup, qershor, 2012 <https://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.12.09.pdf>
- Enti Statistikor i RMV-së-„Kryerësit e veprave penale në vitin 2012”, 2.4.13.11 754, Shkup, qershor, 2013 <https://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.13.11.pdf>
- Foothills Child Advocacy Center, The Impact of Child Pornography on Victims, <https://www.foothillscac.org/>
- Fourkas, Vassilys, What is ‘cyberspace’?, (2004). <https://www.researchgate.net/publication/328928631>
- Health Resources and Services Administration, Cyberbullying, <https://www.dinwiddie.k12.va.us/app/uploads/2018/12/Cyberbullying.pdf>
- <https://smart.ojp.gov/somapi/chapter-4-internet-facilitated-sexual-offending#introduction>
- <https://www.comparitech.com/blog/vpn-privacy/child-abuse-online-statistics/>
- <https://www.dictionary.com/browse/paraphilia>
- [www.lsigurt.al](http://www.lsigurt.al)

- [www.registarnapedofili.mk](http://www.registarnapedofili.mk).
- International Centre for Missing & Exploited Children (ICMEC), Child Sexual Abuse Material: Model Legislation & Global Review, 9th Edition, 2018. <https://www.icmec.org/child-pornography-model-legislation-report/>
- John DiGiacomo, Internet Server Provider Requirements to Report Child Pornography, 2008, <https://revisionlegal.com/internet-law/internet/report-child-pornography/>
- Malware bytes, What is a computer virus?, <https://www.malwarebytes.com/computer-virus>
- Merriam Webster dictionary, 1828, <https://www.merriam-webster.com/dictionary/cybercrime>
- Military News, Cyber sabotage, 2008, <https://www.military.com/defensetech/2008/02/06/cyber-sabotage>
- National Center for Missing and Exploited Children, <https://www.missingkids.org/content/ncmec/en/ourwork/impact.html>
- Nyman Gibson Miralis , Why is cybercrime regarded as a borderless crime? 2021, <https://ngm.com.au/cybercrime/borderless-crime>
- Paul Bischoff, The rising tide of child abuse content on social media, 2021,
- Ph.D.Michael Seto, Internet-Facilitated Sexual Offending , U.S. Department of Justice, 2015.
- Policia e Kosovës, Departamenti i hetimeve <https://www.kosovopolice.com/departamentet/departamenti-i-hetimeve/>
- Policia e shtetit, Republika e Shqipërisë <https://www.asp.gov.al/departamenti-per-policine-kriminale/>
- Psychology Today, 2021 Sussex Publishers, LLC <https://www.psychologytoday.com/us/basics/hebephilia>
- Platforma kombëtare për sigurinë e fëmijëve në internet, <https://www.isigurt.al/rreth-nesh/misioni-dhe-vizioni>

- Platforma kombëtare për sigurinë e fëmijëve në internet, <https://www.isigurt.al/lajme/isigurtal-40-e-faqeve-pornografike-te-raportuara-gjate-vitit-2020-jane-me-femijeve-shqiptare>
- Stanford Encyclopedia of Philosophy, Pornography and Censorship, 2012, <https://plato.stanford.edu/entries/pornography-censorship/#WhaPor>
- T.C. İçişleri Bakanlığı Emniyet Genel Müdürlüğü -Siber Suçlarla Mücadele Daire Başkanlığı, 2019, <https://www.egm.gov.tr/siber/hakkimizda2>
- U.S. Department of Justice, 950 Pennsylvania Avenue, NW, Washington, DC 20530-0001 <https://www.justice.gov/criminal-ceos/child-pornography>
- United Nations Human Rights Office of the High Commissioner, Child pornography flourishes in a world with no borders, 2009, <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/ChildPornography.aspx>
- World Population Review, Countries Where Porn Is Illegal 2021, <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/countries-where-porn-is-illegal>